


STEREOTIPET GJINORE DHE ZGJEDHJET NË KARRIERË NË KOSOVË



Autorë

Venera Demukaj
Edona Maloku
Anyla Beqa

Partner Kreativ

Eris Visoka

Mbështetur nga:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Përkthimi
Genta Shabani

Përmbajtja:

1: Hyrje.....	4-8
1.1: Konteksti.....	7
1.2: Studimi aktual.....	8
2: Metodologjia.....	9-16
2.1: Anketimi: Përshkrimi dhe madhësia e Mostrës.....	10-13
2.2: Anketa.....	14
2.3: Teknika e vlerësimit	15
2.4: Teknika e vlerësimit.....	15-16
3: Rezultatet e Hulumtimit	17-33
3.1: A ka dallime gjinore në performancën e përgjithshme akademike?.....	18-19
3.2: A ka preferenca gjinore për lëndët shkollore?.....	20
3.3: A ka dallime gjinore në performancën akademike dhe në vetë-perceptimet për aftësi?.....	21-23
3.4: A kanë vajzat/djemtë përvoja të ndryshme në lëndën e matematikës?...23-24	
3.5: A ka dallime gjinore në fushat e preferuara për studim?.....	24-26
3.6: Roli i prindërve në zgjedhjet e nxënësve në karrierë.....	27-28
3.7: A ka stereotipe gjinore për profesione specifike?	29-33
4: Përmbledhje e Gjetjeve të Hulumtimit.....	34-37
5: Përfundimet dhe Rekomandimet.....	38-42
Referencat.....	43-46

Gratë në përgjithësi punojnë në punë që kanë të bëjnë me **“njerëzit”**, ndërsa burrat punojnë me **“gjësende”** (Su, Rounds, & Armstrong, 2009).





1: Hyrje

Të dhënat globale tregojnë se tregjet e sotme të punës janë të ndara në baza gjinore (Komisioni Evropian, 2014). Gratë në përgjithësi punojnë në punë që kanë të bëjnë me “njerëzit”, ndërsa burrat punojnë me “gjësende” (Su, Rounds, & Armstrong, 2009). Dallimet gjinore po ashtu janë të dukshme në pozita superiore ose udhëheqëse nëpër sektorë ku burrat mbizotërojnë në pozita të larta pune dhe paguhen më shumë se gratë (Blackburn, Jarman, & Racko, 2014). Sipas Eurostat (2019), gratë në Bashkimin Evropian kanë fituar mesatarisht 16.0% më pak se burrat bazuar në të ardhurat bruto për orë në vitin 2017. Ballkani Perëndimor nuk bën përjashtim nga këto trende globale. Gratë në rajonin e Ballkanit Perëndimor fitojnë më pak se burrat dhe ky dallim rritet për disa shtete pas kontrollimit për karakteristikat e tregut të punës (Avlijas, Ivanovic, Vladislavjevic, & Vujic, 2013).

Ndonëse ka shumë faktorë që kontribuojnë në dallimet gjinore në paga, duke përfshirë nivelin e pozitës në punë, përgjegjësitë ndaj familjes, orët në punë dhe niveli i shkollimit, një pjesë e këtij dallimi shpjegohet po ashtu nga ndarja e grave dhe burrave në profesione të caktuara: gratë zgjedhin fusha studimi/profesione që paguhen më pak sesa fushat e studimit/profesionet që zgjedhen nga burrat në përgjithësi (Chamberlain & Jayraman, 2017). Të dhënat nga një studim mbi dallimet gjinore në paga, i bërë në pesë vende (Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Australi, Gjermani dhe Francë), sugjerojnë se këto dallime u atribuohen kryesisht ndarjes së burrave dhe grave në profesione dhe industri të caktuara (Chamberlain, 2016). Edhe pse numri i grave me diploma universiteti është gjithnjë e më i madh në krahasim me burrat, ato vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar dukshëm në fusha studimi që do u ofronin punë me pagë të lartë (Chamberlain & Jayraman, 2017). Për shembull, në Shtetet e Bashkuara burrat mbizotërojnë në nëntë nga dhjetë drejtimet me pagat më të larta ndërsa gratë mbizotërojnë në gjashtë nga dhjetë drejtimet me pagat më të ulëta (Chamberlain & Jayraman, 2017). Të dhënat nga Evropa gjithashtu tregojnë një situatë të ngjashme: në përgjithësi, gratë janë të mbipërfaqësuar në shkencat humane, gjuhë, arsim dhe art, dhe të nënpërfaqësuar në degët shkencore dhe teknike (Turner & Bowen, 1999).

Hulumtimet në rritje e sipër tregojnë se ndarja gjinore në zgjedhjet në karrierë ndodh për shkak të besimeve stereotipike se burrat performojnë më mirë në lëndët që lidhen me matematikë, të cilat pastaj ndikojnë negativisht në vetëbesimin dhe performancën e grave në detyra që lidhen me matematikë dhe i dekurajojnë ato që të ndjekin karriera në fusha shkencore dhe teknike (Bian, Leslie & Cimpian, 2017). Për shembull, fenomeni i quajtur “kërcënim nga stereotipi” (Steele & Aronson, 1995) shpjegon se si stereotipet negative të një grupi (p.sh., gratë janë më të dobëta në matematikë ose në përgjithësi në Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë – STEM), ndikojnë që anëtarët e atij grupi të zhvlerësojnë të performojnë më dobët dhe të arrijnë rezultate më të ulëta për shkak të kërcënimit që nxitet

nga stereotipi negativ. Stereotipet negative që gratë janë më të dobëta në matematikë, ose në shkencë në përgjithësi, fillojnë që nga shkolla fillore (Weinhardt, 2017). Djemtë vetë-raportojnë se janë më kompetentë në matematikë sesa në gjuhë në krahasim me vajzat që mendojnë se kanë 4 kompetenca më të larta në gjuhë sesa në matematikë (Weinhardt, 2017). Këto ndryshime në vetë-perceptim fillojnë të bëhen të dukshme përgjatë klasës së 5-të dhe 12-të (Weinhardt, 2017). Kur krahasojnë kompetencat tek të rriturit, fëmijët në shkolla i shohin burrat si më të mirë në matematikë sesa gratë (Steele, 2003). Kjo marrëdhënie pozitive mes burrave dhe matematikës vazhdon të jetë prezente edhe më vonë në jetë (p.sh. te studentët në universitet) ku ekziston një lidhje e nënkuptuar (implicite) mes meshkujve dhe matematikës (Nosek, Banaji, & Greenwald, 2002). Prindërit dhe mësuesit gjithashtu shprehin paragjykime gjinore në vlerësimin e kompetencave matematikore të fëmijëve. Për shembull, gjetjet e kaluara tregojnë se prindërit (të dy, nënat dhe baballarët) mendojnë se djemtë e tyre kanë aftësi më të larta në matematikë në krahasim me vajzat e tyre (Furnham, Reeves, & Budhami, 2002), ndërsa mësuesit vlerësojnë se nxënësit e tyre meshkuj kanë aftësi më të larta matematikore sesa nxënëset femra (Li, 1999).


Studimet mbi performancën matematikore tregojnë se dallimet gjinore në matematikë janë gjithnjë e më të vogla (Lindberg, Hyde, Petersen, & Linn, 2010; Wilder & Powell, 1989); megjithatë, ende vazhdon të ketë mospërputhje gjinore signifikante në mesin e studentëve me arritjet më të larta në testet e avancuara të matematikës (Ellison & Swanson, 2010). Ngjashëm, rezultatet nga PISA 1 (OECD, 2018: 4) tregojnë se edhe pse dallimet gjinore në performancë shkencore janë të vogla në mesatare për të gjitha vendet “[...] në 33 vende dhe ekonomi, numri i performuesve më të mirë në shkencë është më i lartë në mesin e djemëve sesa vajzave.” Rezultatet gjithashtu tregojnë se në shtetet e OECD, në mesatare, nuk ka dallime gjinore në pritjet e studentëve për të punuar në profesione që lidhen me shkencë (OECD, 2018). Sidoqoftë, këto pritshmëri ndryshojnë kur identifikohet lloji i punës që lidhet me shkencë: vajzat e identifikojnë veten më shumë me profesionet e lidhura me fushën e shëndetësisë ndërsa djemtë e shohin veten më shumë duke punuar në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (OECD, 2018). Këto preferenca duket se pasqyrojnë tendencën që gratë me të vërtetë kanë më shumë tendence të ndjekin punë që kanë të bëjnë me “njerëz” ndërsa burrat me “gjësende” (Su, Rounds, & Armstrong, 2009).

¹Programi për Vlerësimin e Studentëve Ndërkombëtar (PISA), i nisur nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) me qëllim të vlerësimit të njohurive dhe aftësive të studentëve 15-vjeçar afër përfundimit të arsimit të tyre të detyrueshëm. Vlerësimi i fundit nga PISA (në vitin 2015) ka përfshirë 72 vende dhe sisteme arsimore (Rezultatet e PISA-s në Fokus, OECD, 2018), link: <https://www.oecd.org/pisa/pisa-2015-results-in-focus.pdf>

1.1 Konteksti: Sa janë zgjedhjet në karrierë në arsimin e lartë në Kosovë të ndara në baza gjinore?

Të dhënat nga 2017/2018 mbi numrin e studentëve në një prej universiteteve më të vjetra dhe më të mëdha në vend - Universiteti i Prishtinës - tregojnë se gratë tejkalojnë burrat në arsim të lartë (58% në 42%). Kur ndahen në bazë të fushës së studimit, të dhënat konfirmojnë tendencat globale në ndarjen e profesioneve sipas gjinisë. Siç tregohet në Figurën 1, gratë mbizotërojnë fushat e studimeve si Edukim (93%), Filologji (81%) dhe Filozofi (69%), ndërsa burrat dominojnë në fushat e studimit si Inxhinieri Mekanike (79%), Sport (72%), dhe Arkitekturë dhe Ndërtimtari (69%).

Figura 1. Shpërndarja gjinore e studentëve të Universitetit të Prishtinës 2017/18 (%)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2018

Ndonëse gratë kanë tendencë të zgjedhin më shumë fusha studimi në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Matematikës sesa burrat (67% me 33%), ato janë ende të nënpërfaqësuar në degë teknike që paguhen më lartë siç janë Inxhinieria Elektrike dhe Kompjuterike (38% me 62%).


1.2 Studimi aktual

Pyetja kryesore që ne bëjmë në këtë studim është pse vajzat vazhdojnë të studiojnë fusha që janë “të orientuara kah njerëzit” dhe rrjedhimisht punojnë në punë me paga të ulta, ndërsa djemtë preferojnë fusha që janë “të orientuara kah gjësendet” dhe rrjedhimisht punojnë në punë me paga të larta? Edhe pse në Kosovë nuk ka pasur ndonjë analizë gjithëpërfshirëse mbi këtë temë, nënkuptohet se “perceptimet tradicionale të punëve që janë më të përshtatshme për gra ose për burra” janë një variabël e rëndësishme shpjeguese (Banka Botërore, 2002: 3). Ky studim analizon preferencat e studentëve të rinj kosovarë, të klasave 11të dhe 12të, në zgjedhjen e fushës së tyre të studimit në shkollim të lartë. Specifikisht, studimi identifikon faktorët që iu japin kahje zgjedhjeve të të rinjve në karrierë përmes tre aspekteve: përvojave të tyre shkollore dhe vetë-konceptit akademik; diskutimeve/konsultimeve (ose mungesës së tyre) me prindërit dhe qendrat për zhvillim të karrierës; dhe perceptimeve të profesioneve specifike për një gjini. Sipas njohurive tona, ky studim paraqet studimin e parë eksplorues që shqyrton në mënyrë specifike marrëdhëniet ndërmjet stereotipizmit gjinor dhe zgjedhjeve në karrierë të bëra nga vajzat dhe djemtë e rinj në Kosovë.

Ky studim ka poashtu rëndësi kontekstuale pasi që të dhënat empirike tregojnë se mundësitë e limituara të grave për fitim financiar betonojnë jo vetëm varfërinë dhe pabarazinë e grave në shoqëri, por gjithashtu vëshirësojnë daljen e shoqërive nga rrethi vicioz i të ardhurave të ulëta dhe produktivitetit të ulët (Todaro & Smith, 2012).

² Statistikat për përfaqësimin gjinor në shkollat e mesme të Kosovës sipas MASHT (2015) tregojnë se 47% janë femra dhe 53% meshkuj. Sidoqoftë, për shkak se fokusi i studimit tonë është tek vajzat e reja në veçanti, ne i kemi përfaqësuar ato më shumë në mostër.

Studimi përfshin një anketim mbarëkombëtar (**N = 1,050**) me djem dhe vajza në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10 dhe 11) dhe katër fokus grupe me **nxënës** nga shkolla të mesme dhe **studentë** universiteti të vitit të parë nga fakultetet e shkencave sociale dhe shkencave natyrore. Analizat nga anketimi dhe fokus grupet përshijnë nxënës nga **komunitetet shumicë dhe pakicë** në Kosovë.





2: Metodologjia

Për të kuptuar faktorët që ndikojnë në zgjedhjet në karrierë të të rinjve në Kosovë, ne kemi bërë një studim me studentë të shkollave të mesme dhe të universitetit, nga dy gjinitë. Pjesa kuantitative e studimit përfshin një anketim mbarëkombëtar me djem dhe vajza në arsimin e mesëm të lartë, pasuar nga katër diskutime në fokus grupe me studentë të shkollave të mesme dhe studentë të universitetit nga shkencat shoqërore dhe shkencat natyrore. Mbledhja e të dhënave është bërë nga një kompani vendore (UBO Consulting) të cilët ishin përgjegjës për punën në terren në gjithë vendin.

2.1 Anketimi: Përshkrimi dhe madhësia e Mostrës

Studimi i raportuar këtu përmban një mostër prej 1,050 të anketuarish nga 99 shkolla të mesme në total (shihni Tabelën 1 për përqindjen e secilit lloj të shkollës). Përzgjedhja e nxënësve nga gjimnazet dhe shkollat profesionale është bërë në bazë të shpërndarjes së atyre shkollave në komunat përkatëse.

Tabela 1. Llojet e shkollës të përfshira në mostër


Lloji i shkollës	Frekuenca	%
Gjimnaz	487	46.4
Shkolla Profesionale	563	53.6
Gjithsej	1050	100

Burimi: LEAP, Korrik 2018

Përcaktimi i mostrës është bërë në bazë të statistikave të arsimit për vitin 2015/2016 të cilat pasqyrojnë madhësinë e popullacionit, gjininë, shpërndarjen etnike dhe shpërndarjen gjeografike të nxënësve në Kosovë.

Mostra është ndarë sipas kuotave të gjinisë (52% vajza; 48% djem) 2 dhe përkatësisë etnike (82% shqiptarë; 6% turq; 5% boshnjakë; 3% serbë; 2% komunitetet Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas; dhe 1% tjera). Meqenëse të dhënat zyrtare nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) tregojnë se përfshirja e komuniteteve pakicë në shkollat e mesme të Kosovës është më pak se 3% (MASHT, 2015), strategjia jonë ishte që të përcaktojmë një mostër më të madhe nga proporcioni etnik i kuotave në mënyrë që të bëjmë krahasime statistikore edhe mes komuniteteve pakicë (dhe jo vetëm krahasime mes shumicës dhe pakicës).³ Prandaj, përsa i përket përbërjes etnike të mostrës, komunitetet minoritare përfaqësojnë rreth 18% të mostrës (188 të anketuar). Në fillim të studimit kemi synuar të kemi një përfaqësim edhe më të lartë të komuniteteve pakicë por mostra është adaptuar gjatë rrjedhës së anketimit pasi që anketuesit kishin vështirësi në identifikimin e studentëve në bazë të përkatësisë së tyre etnike.⁴

Figura 2: Mostra e studimit, e ndarë në bazë në grupeve etnike



Burimi: LEAP, Korrik 2018

Mostra gjithashtu është shtresuar në bazë të niveleve të klasave, d.m.th., të anketuarit janë ndarë mes klasave 11-të dhe 12-të; pas mbledhjes së të dhënave kjo ndarje mes dy grupeve qëndron mirë (48% në klasën 11-të dhe 52% në klasën 12-të). Jemi përqendruar tek klasat 11-të dhe 12-të pasi këto janë vitet e fundit para se studentët të përfundojnë shkollën e mesme dhe të vendosin për fushat e tyre të studimit. Paralelet nga klasat 11-të dhe 12-të janë zgjedhur me aplikim të gjeneratorit të numrave të rastit. Mostra është marrë nga 28 komuna. Numri më i madh i të anketuarve vjen nga rajoni i Prizrenit; kjo për shkak të mbipërfaqësimit të mostrës së studentëve nga Prizreni për shkak të pranisë së lartë të komuniteteve joshqiptare aty (shihni Tabelën 2).

³Të dhënat nga MASHT (2015) nuk përfshijnë studentët pakicë nga sistemi paralel arsimor.

⁴Sipas rregullave të shkollës, studentëve nuk u kërkohet të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike kur regjistrohen në shkollë.

Tabela 2. Vendi i lindjes së të anketuarve

Vendi i Lindjes	Frekuenca	%
Prishtinë/Prishtina	136	13.0
Mitrovicë/Mitrovica	35	3.3
Gjilan/Gnjilane	36	3.4
Peje/Pec	67	6.4
Prizren	213	20.3
Gjakovë/Djakovica	46	4.4
Podujevë/Podujevo	37	3.5
Vushtrri/Vucitrn	32	3.0
Skenderaj/Srbica	14	1.3
Junik/Junik	3	0.3
Klinë/Klina	19	1.8
Istog/Istok	27	2.6
Deçan/Decani	13	1.2
Dragash/Dragash	17	1.6
Suharekë/Suva Reka	30	2.9
Rahovec/Orahovac	23	2.2
Viti/Vitina	24	2.3
Kamenicë/Kamenica	22	2.1
Lipjan/Lipljan	24	2.3
Shtime/Stimlje	16	1.5
Mamusha/Mamus	26	2.5
Ranillug/Ranilug	23	2.2
Ferizaj/Urosevac	65	6.2
Kaçanik/Kacanik	13	1.2
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	22	2.1
Obiliq/Obilic	6	0.6
Novobërdë/Novo Brdo	1	0.1
Zubin Potok	1	0.1
Zveçan/Zvecan	1	0.1
Glllogovc/Glogovac	24	2.3
Malishevë/Malisevo	30	2.9
Hani i Elezit/General Jankovic	3	0.3
Graçanica/Gracanica	1	0.1
Gjithsej	1050	100.0

Burimi: LEAP, Korrik 2018

Në anketë po ashtu kemi kërkuar informacione për anëtarët e familjes së të anketuarve, përfshirë nivelin e shkollimit të prindërve dhe statusin e punësimit. Rezultatet nga analizat e frekuencës tregojnë se niveli i shkollimit të nënave të të anketuarve reflekton pozitën e përgjithshme të grave në shoqërinë kosovare: nënat kanë nivele më të ulëta shkollimi, janë dukshëm më të papunësuar dhe janë të angazhuara si shtëpiake (shihni Tabelat 3 dhe 4). Krahasimi i nivelit të shkollimit të prindërve në bazë të gjinisë tregon që burrat (baballarët) kanë më shumë vite shkollimi në krahasim me gratë (nënat). Rreth 40 përqind e të anketuarve raportuan se baballarët e tyre kanë më shumë vite shkollimi sesa nënat e tyre, ndërsa më shumë se 50 përqind e të anketuarve kanë prindër me të njëjtin nivel shkollimi. Vetëm 6 përqind e të anketuarve raportuan se nënat e tyre kanë arritje më të larta shkollore sesa baballarët e tyre.

Tabela 3. Niveli i shkollimit të prindërve

	Nëna		Babai	
	Frekuenca	%	Frekuenca	%
Nuk ka përfunduar shkollën fillore	74	7.0	26	2.5
Ka përfunduar shkollën fillore	390	37.1	160	15.2
Ka përfunduar shkollën e mesme	424	40.4	565	53.8
Vijon shkollën e lartë/universitetin	22	2.1	47	4.5
Ka përfunduar shkollën e lartë/ universitetin	101	9.6	158	15.1
Vijon masterin	4	0.3	5	0.5
Ka përfunduar masterin	11	1.0	37	3.5
Ka përfunduar doktoraturën	2	0.2	6	0.6
Gjithsej	1027	97.8	1005	95.7
Nuk ka përgjigje	23	2.2	45	4.3
Gjithsej	1050	100.0	1050	100.0

Burimi: LEAP, Korrik 2018

Tabela 4. Statusi i punësimit të prindërve

	Nëna		Babai	
	Frekuenca	%	Frekuenca	%
Punësuar në sektorin privat	123	11.7	445	42.3
Punësuar në sektorin publik/shtetëror	71	6.8	217	20.7
Vetëpunësuar (ka biznesin e vet)	40	3.8	166	15.9
Punësuar jashtë vendit	10	0.9	53	5.0
Në pension	4	0.4	14	1.3
Student/e	1	0.1	1	0.1
Nuk punon	777	74.0	109	10.4
Gjithsej	1027	97.8	1005	95.7
Nuk ka përgjigje	23	2.2	45	4.3
Gjithsej	1050	100.0	1050	100.0

Burimi: LEAP, Korrik 2018

2.2 Anketa

Anketa përbëhej nga katër pjesë (shihni Shtojcën 1):

- **Pjesa demografike.** Në këtë pjesë janë mbledhur informata për moshën, gjininë, përkatësinë etnike, llojin e shkollës, performancën paraprake në shkollë (suksesin përfundimtar); informata për anëtarët e familjes së të anketuarit (prindërit si dhe vëllëzërit dhe motrat mbi moshën 18 vjeç); si dhe nivelin e tyre të shkollimit dhe statusin e punësimit.

- **Përvoja në shkollë dhe vetë-koncepti akademik.** Nxënësit janë pyetur për lëndët e preferuara shkollore; vetë-perceptimet për matematikë dhe gjuhë; si dhe perceptimet për dallimet gjinore në aftësitë e matematikës, gjuhës dhe sportit. Studimi ynë është përqëndruar në matematikë dhe gjuhë pasi që studimet e mëparshme sugjerojnë se këto dy lëndë zakonisht reflektojnë stereotipet gjinore në zgjedhjet në karrierë (Cheryan, Master, & Meltzoff, 2015; Weinhardt, 2017).

Performanca e përgjithshme akademike e studentëve është raportuar në bazë të sistemit aktual të klasifikimit në shkollat e mesme në Kosovë, prej 1 deri 5, ku 1 = pamjaftueshëm; 2 = mjaftueshëm; 3 = mirë; 4 = shumë mirë; dhe 5 = shkëlqyeshëm. Duke u bazuar në këtë sistem të notimit, ne gjithashtu kemi përdorur të njëjtën shkallë (1-5) për të matur perceptimin e studentëve për aftësitë dhe përvojat e tyre akademike. Pyetjet mbi vetë-konceptin për matematikë janë përshtatur nga OECD (2013).

- **Zgjedhjet në karrierë.** Në këtë pjesë nxënësit janë pyetur nëse kanë vendosur për studimet e tyre të ardhshme; cilat janë fushat e tyre të preferuara; dhe cili ka qenë ose është roli i prindërve të tyre, mësuesve, miqve dhe qendrave për zhvillim të karrierës në proceset e vendimmarrjes për zgjedhjet në karrierë që ata planifikojnë të bëjnë.

- **Stereotipet gjinore.** Nxënësit janë pyetur se si perceptojnë rolet specifike gjinore në profesione që konsiderohen tipike për gra, kundrejt atyre tipike për burra; tre profesione nga Shëndetësia, Edukimi i Hershëm dhe Rolet Shtëpiake (HEED), që zakonisht perceptohen të jenë në përputhje me rolet e grave, dhe tre profesione nga Shkenca, Teknologjia, Inxhinieria dhe Matematika (STEM), që zakonisht perceptohen të jenë në përputhje me rolet e burrave. Ne gjithashtu kemi pyetur nxënësit për perceptimet e tyre mbi gjendjen aktuale kur bëhet fjalë për ndarjet gjinore në tregun e punës dhe pastaj u kemi bërë një pyetje normative, si "kush duhet të punojë si infermier/e; arkitekt/e; specialist/e i/e teknologjisë së informacionit." Pyetjet janë përshtatur nga studimi i UCOM (Kuptimi i Orientimit Komunal në Meshkuj, <https://ucom2017.wordpress.com/>) i cili studim kryhet në 58 vende të botës, ku autorja e dytë (Maloku) e këtij raporti është përfaqësuese për Kosovë. Tre profesionet e përfshira në HEED ishin: mësues/e në shkollë filllore; infermier/e; dhe punëtor/e social/e" (kjo e fundit u zëvendësua me "arkëtar/e" pasi që përshtatej më shumë me kontekstin e Kosovës), ndërsa ato të përfshira në profesionet e STEM ishin: specialist/e i/e teknologjisë informative; Inxhinier/e elektrik/e; dhe arkitekt/e.

Versioni përfundimtar i pyetësorit reflekton edhe kontributet nga përfaqësuesit e projektit Enhancing Youth Employment (EYE) dhe studiuesit e UBO Consulting. Shkalla e përgjithshme e përgjigjeve në anketim ishte e lartë (97.7%). Kjo do të thotë se nga 1,075 të të anketuarve që u kontaktuan, anektuesit arritën të kryenin 1,050 intervista personale të asistuar nga kompjuteri.

2.3 Teknika e vlerësimit

Rezultatet janë analizuar dhe prezantuar me teknikën e tabelimit të kryqëzuar. Fokusi i analizës së tabelave të kryqëzuara ishte theksimi i dallimeve gjinore dhe etnike në përgjigjet e të anketuarve. Rëndësia statistikore e këtyre dallimeve është testuar me ANOVA dhe t-teste. Të gjitha analizat e raportuara këtu janë bërë në STATA dhe SPSS.

2.4 Diskutimet në Fokus Grupe

Pas përfundimit të anketimit dhe analizimit të rezultateve të para, janë mbajtur katër (4) diskutime në fokus grupe për të mbledhur informata kualitative për zgjedhjet e studentëve në karrierë. Diskutimet në fokus grupe janë organizuar me nxënës të shkollave të mesme nga klasat e 11-ta dhe 12-ta që studionin shkenca natyrore dhe shkenca shoqërore, si dhe me studentë universiteti të regjistruar në vitin e parë në programe STEM dhe jo-STEM. Pjesëmarrësit në këto fokus grupe ishin djem dhe vajza nga komunitetet shumicë dhe jo-shumicë në Kosovë, duke përfshirë komunitetin shqiptar, serb, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, goran dhe turk. Në përgjithësi, pjesëmarrësit e fokus grupeve janë angazhuar në mënyrë aktive në diskutim.

Tabela 5. Përbërja e fokus grupeve

Pjesëmarrësit në fokus grupe	Përbërja e fokus grupeve
Fokus grup me 12 vajza dhe djem nga komuniteti shqiptar	- klasat 11 dhe 12 në shkolla të mesme ku studiohen shkencat sociale dhe shkencat natyrore (klasa 11 dhe 12) - viti i parë në universitet, programet STEM dhe jo-STEM
Fokus grup me 12 vajza nga komuniteti shqiptar	- klasat 11 dhe 12 në shkolla të mesme ku studiohen shkencat sociale dhe shkencat natyrore - viti i parë në universitet, programet STEM dhe jo-STEM
Fokus grup me 12 vajza dhe djem nga komuniteti serb	- klasat 11 dhe 12 në shkolla të mesme ku studiohen shkencat sociale dhe shkencat natyrore - viti i parë në universitet, programet STEM dhe jo-STEM
Fokus grup me 12 vajza dhe djem nga komuniteti rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, goran dhe turk	- klasat 11 dhe 12 në shkolla të mesme ku studiohen shkencat sociale dhe shkencat natyrore - viti i parë në universitet, programet STEM dhe jo-STEM

Burimi: LEAP, Nëntor 2018

Temat e diskutimeve në fokus grupe kanë pasqyruar përmbajtjen e anketës dhe kanë ndjekur të njëjtën sekuencë gjatë pikave të diskutimit:

- Vetë-raportim të lëndëve shkollore të preferuara dhe vetë-vlerësim të kompetencave në matematikë dhe gjuhë;
- Fushat e zgjedhura për studim/në karrierë dhe faktorët që ndikojnë në këto zgjedhje;
- Zgjedhjet në karrierë dhe stereotipet gjinore: vlerat profesionale; ndarjet gjinore në tregun e punës; dhe ndarjet gjinore në pozitat udhëheqëse.

Të gjitha diskutimet në fokus grupe janë moderuar nga një moderator i trajnuar nga UBO Consulting, dhe janë zhvilluar me ndihmën e Udhëzuesit për Fokus Grupe, të strukturuar specifikisht për këtë qëllim (shihni Shtojcën 2).


Pjesët në vijim prezantojnë rezultatet kryesore nga kombinimi i dy segmenteve të studimit, atij kuantitativ (d.m.th anketimi mbarëkombëtar) dhe kualitativ (d.m.th fokus grupet).

“Unë po ashtu vlerësoj humanizmin para fitimeve personale pasi që ne merremi me njerëz gjithë kohën dhe përse të mos u ndihmojmë atyre”

- Pjesëmarrëse nga fokus grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Për mua si programer, është e rëndësishme që para së gjithash të kem përfitime financiare përmes profesionit tim”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar






3: Rezultatet e Hulumtimit

3.1 A ka dallime gjinore në performancën e përgjithshme akademike?

Rezultatet treguan se performanca e vetë-raportuar (suksesi përfundimtar) tek nxënësit shkon duke u zvogëluar gjatë kohës që ata dalin në klasë më të larta. Siç shihet në Figurën 3, gjersa përqindja e nxënësve të shkëlqyer në klasën e 5-të arrin në gati 70% të të anketuarve (ose 720 nxënës nga gjithsej 1050), në klasat 9-të dhe 10-të, bie në rreth 56% dhe 36%. Në të njëjtën kohë rritet përqindja e nxënësve me sukses të “shumë mirë” dhe “mirë”. Edhe pse suksesi i shkëlqyeshëm bie në përgjithësi në klasë më të larta, **përqindja e vajzave me nota të shkëlqyera është më e lartë se e djemve përgjatë gjithë niveleve të shkollimit**. Përqindja e vajzave me sukses të shkëlqyeshëm është më e lartë qysh nga klasa e 5-të dhe ky dallim në favor të vajzave vazhdon të rritet më tej në shkollën e mesme (përkatësisht klasat 9-të dhe 10-të).

Figura 3: Suksesi i përgjithshëm i nxënësve përgjatë viteve (%)




Burimi: LEAP, Korrik 2018. Shënim: performanca akademike është vetë-raportimi i studentëve për performancë (GPA). Shkalla e notave është 1 deri 5, ku 1=pamjaftueshëm, 5=shkëlqyeshëm

Sipas përkatësisë etnike, përqindja më e lartë e studentëve të shkëlqyer në klasat 5, 9 dhe 10 raportohet në mesin e shqiptarëve, ndjekur nga studentët boshnjakë dhe turq; përqindja më e lartë e studentëve shumë të mirë raportohet në mesin e studentëve serbë dhe goranë. Derisa vetëm një pjesë e vogël e studentëve raportojnë se kanë sukses më të ulët ("mjaftueshëm" ose "të pamjaftueshëm"), kjo pjesë rritet për disa pikë në përqindje në klasën e 10-të. Përqindja më e lartë e studentëve me rezultat "të mjaftueshëm" në klasën e 10-të është në mesin e studentëve ashkalinjë (15.4%), pasuar nga egjiptianët (9.1%), gjë që tregon se performanca e dobët në arsim është veçanërisht e pranishme në mesin e grupeve etnike përgjithësisht të stigmatizuara.

Kur krahasojmë mesataret e notave në matematikë dhe në gjuhën amtare në arsimin e mesëm të lartë (Figura 4), rezultatet tregojnë se, krahasuar me djemtë, performanca akademike e vajzave në këto dy lëndë është përsëri më e lartë në të tre nivelet e klasave (10-të, 11-të, dhe 12-të).

Figura 4. Performanca në matematikë dhe gjuhë në arsim të mesëm të lartë




Burimi: LEAP, Korrik 2018. Shënim: performanca akademike është vetë-raportimi i notave në matematikë dhe gjuhë amtare (GPA). Shkalla e notave është 1 deri 5, kur 1=pamjaftueshëm, 5=shkëlqyeshëm

Studentëve po ashtu u është kërkuar të zgjedhin lëndët në të cilat kishin notat më të mira. Në këtë pyetje, vajzat raportuan nota më të mira në gjuhën amtare, psikologji dhe biologji; ndërsa djemtë raportuan dukshëm nota më të mira në informatikë, kulturë fizike dhe gjeografi. Edhe këtu, përqindja e vajzave që kanë notat më të mira në "të gjitha lëndët" është më shumë se dyfish më e lartë se ajo për djemtë (6.9% djem dhe 16.3% vajza).

3.2 A ka preferenca gjinore për lëndët shkollore?

Edhe pse vajzat raportuan se performojnë njëloj mirë në shkencat shoqërore dhe ato natyrore, preferencat e tyre të rendit të parë ishin për lëndët që përfshijnë më shumë aftësi verbale (shihni Figurën 5). Kur janë pyetur të zgjedhin deri në tre lëndë shkollore më të preferuarat, vajzat kanë preferuar **më shumë gjuhë dhe më pak matematikë**. Preferenca e tyre ishte dukshëm më e ulët për lëndët shkencore si fizika dhe gjeografia, dhe ishte statistikiisht më e lartë për gjuhët dhe psikologjinë. Nga grupi i shkencave natyrore, vajzat kishin prirje të pëlqejnë biologjinë dhe kiminë më shumë sesa djemtë, gjë që mund të shpjegojë preferencën e tyre për studime në mjekësi në universitet. Është interesante të theksohet se vajzat preferojnë fizikën më pak sesa djemtë, edhe pse përqindja e vajzave që kanë raportuar të kenë nota më të mira në këtë lëndë është më e lartë sesa te djemtë (9.5% djem dhe 12.1% vajza). Në anën tjetër, **djemtë raportojnë preferenca më të larta për lëndë si informatika, kultura fizike dhe gjeografia**. Kur bëhet fjalë për matematikë, edhe pse mesataret e preferencave për këtë lëndë janë më të larta sesa për shkencat e tjera natyrore (p.sh., Fizikë dhe Kimi), dallimet mes djemve dhe vajzave nuk ishin statistikiisht domethënëse.

Figura 5. Gjinia dhe preferencat për lëndët shkollore (frekuencat)




Burimi: LEAP, Korrik 2018. Shënim: Studentët kishin mundësi të zgjedhnin deri në tre lëndë shkollore; të gjitha dallimet statistikore signifikante janë shënuar me yll (*)

Në kontekstin e dallimeve etnike, dhe pavarësisht nga gjinia, diskutimet në fokus grupe treguan se gjuha angleze ishte ndër lëndët më të preferuara për shqiptarët dhe komunitetet e tjera jo-shumicë përveç serbëve të cilët favorizuan gjuhët serbe dhe ruse.

3.3 A ka dallime gjinore në performancën akademike dhe në vetë-perceptimet për aftësi?

Në përputhje me performancën e tyre të përgjithshme akademike, vajzat raportuan të kenë më shumë aftësi në matematikë, por edhe më shumë aftësi në gjuhë në krahasim me djemtë, të shprehura përmes mesatareve për aftësitë e vetë-raportuara (shihni Figurën 6).

Figura 6. Vetë-perceptimet akademike të studentëve sipas gjinisë




Burimi: LEAP, Korrik 2018; Shkalla: 1=aspak to 5= shumë

Sidoqoftë, është interesante të krahasohen notat e vetë-raportuara (notat aktuale) të vajzave në matematikë me vetë-perceptimin e tyre për aftësi në këtë lëndë (figura 4 dhe figura 6). Rezultatet tregojnë një **mospërputhje** mes tyre; mesatarja e përgjithshme e vajzave për vetë-perceptim të aftësive në matematikë (mesatarja = 3.36) është më e ulët se mesatarja e përgjithshme e notës së tyre të vetë-raportuar përgjatë arsimit të mesëm të lartë (mesatarja = 3.75; mesatarja_{klasa10} = 3.69; mesatarja_{klasa12} = 3.79). Në anën tjetër, djemtë raportojnë perceptime ndryshe: mesatarja e tyre e vetë-perceptimit se janë të mirë në matematikë (mesatarja = 3.25) është shumë afër ose nganjëherë më e lartë se mesatarja e përgjithshme e notës së tyre në këtë lëndë (mesatarja_{klasa10} = 3.31; mesatarja_{klasa11} = 3.19; mesatarja_{klasa12} = 3.21). Këto gjetje përsëritin gjetjet e studimeve nga vendet tjera ku vetë-raportimi i aftësisë së vajzave në matematikë është më i ulët se performanca e tyre aktuale në këtë lëndë (shihni Weinhardt, 2017).

Rezultatet gjithashtu treguan dallime domethënëse midis grupeve etnike. Vetë-aftësia më e lartë në matematikë u raportua në mesin e studentëve turq dhe më e ulëta u raportua në mesin e komunitetit goran, rom, egjiptian dhe ashkali (shihni Figurën 7). Gjersa mesatarja totale e vetë-raportimit të aftësisë në gjuhë ishte më e lartë për të gjithë mostrën (3.98), më e ulëta 18 raportohet se ishte në mesin e komunitetit ashkali. Kjo pasqyron gjetjet e mëparshme që tregojnë se anëtarët e grupeve të stigmatizuara në një shoqëri (p.sh., grupet pakicë) kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë efektet e “kërcënimit nga stereotipi” në arritjet akademike (Steele & Aronson, 1995). Pra, kërcënimi nga stereotipi ka shumë nuanca dhe nuk vlen vetëm për gjini.


Figura 7. Vetë-perceptimet akademike të studentëve sipas përkatësisë etnike



Burimi: LEAP, Korrik 2018; Shkalla: 1=Aspak deri 5=Shumë

Paragjykimet gjinore për grupin tjetër (ose grupin e jashtëm) janë prezente kur bëhet fjalë për vetë-perceptimet akademike. Figura 8 konfirmoi perceptimet gjinore të stereotipeve, ku djemtë raportuan perceptime më të ulëta për aftësitë e vajzave në të tre lëndët krahasuar me vetë-perceptimet e vajzave për nivelin e tyre të kompetencës. Sidoqoftë, perceptimi i vajzave për nivelin e kompetencës së djemve në matematikë dhe sport nuk ishte dukshëm më ndryshe nga perceptimi i djemve për vetë-kompetencën e tyre në këto dy lëndë, përveç gjuhëve ku vajzat raportuan perceptime të ulëta për kompetencën e djemve.

Figura 8. Stereotipet gjinore dhe performanca në lëndë




Burimi: LEAP, Korrik 2018; Shkalla: 1=Aspak deri 5=Shumë

Gjersa mesatarja më e ulët e vlerësimit të vajzave për kompetencën e djemve ishte në gjuhë, vetë-raportimi për kompetencën e tyre në gjuhë ishte më i larti. Në anën tjetër, mesatarja më e ulët e vlerësimit të djemve për kompetencën e vajzave ishte në sport, kurse vetë-raportimi për kompetencën e tyre në sport ishte më i larti. Mund të themi se kur vajzat krahasojnë veten me djemtë, ndihen se janë më kompetente dhe më të afta në gjuhë. Kjo po ashtu reflektohet në zgjedhjet e tyre të ardhshme në karrierë ku vajzat preferojnë studimin e shkencave sociale më shumë sesa STEM.

3.4 A kanë vajzat dhe djemtë përvoja të ndryshme në lëndën e matematikës?

Rezultatet nuk tregojnë ndonjë dallim domethënës midis vajzave dhe djemve kur bëhet fjalë për të qenit aktiv në klasë. Sidoqoftë, në krahasim me djemtë, **vajzat raportojnë nivele më të larta stresi dhe shqetësimi gjatë testeve të matematikës**. Mesataret për “ndjenjën e stresit gjatë testeve të matematikës” dhe “ndjenjën e shqetësimit për notën përfundimtare në matematikë”; ishin statistikiisht dukshëm më të larta për vajzat sesa për djemtë (në $p < 0.05$), duke sugjeruar prezencën e kërcënimit nga stereotipi tek vajzat.

Figura 9. Eksperiencat e studentëve gjatë orëve dhe testeve të matematikës



Burimi: LEAP, Korrik 2018; Shkalla: 1=Aspak nuk jam dakord deri 5=Jam shumë dakord

Shënim: Të gjitha dallimet statistikisht të rëndësishme janë shënuar me yll (*)

Hulumtimi jonë kualitativ tregoi se vajzat pjesëmarrëse në fokus grupin vetëm me vajza raportuan të kenë shumë stres dhe ankth gjatë orëve dhe testeve të matematikës (Kutia 1). Është me rëndësi të theksohet se ky shqetësim u nda nga vajzat vetëm atëherë kur ishin në mesin e një fokus grupi me vajza. Pjesëmarrësit nga fokus grupet tjera raportuan që provimet e matematikës nuk ishin aq stresuese për dy arsye, ose për shkak se ata/ato ishin të mirë/a në matematikë, ose sepse nuk i kushtonin shumë kohë dhe nuk e konsideronin të rëndësishme.



Kutia 1. Eksperienat me klasët dhe testet e matematikës

“Matematika nuk është shumë lodhëse për mua. Mendohem të bëj atë çfarë thotë profesori që duhet të bëjmë, por kur bëhet fjala për provime, bllokohem plotësisht. As nuk mundem të shpjegoj stresin që përjetoj. Më duket se gjithçka që kam mësuar ka qenë për asgjë.”

- Pjesëmarrëse nga grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Gjithmonë jam e stresuar para provimeve në matematikë. Më ka shkaktuar vëshirësi në mësim. Gjithmonë frikësohem se do harroj gjithçka që kam mësuar.”

- Pjesëmarrëse nga grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Më duket se njerëzit janë më të fokusuar në gjuhë sepse ato ju nevojiten dhe i përdorin më shumë. Në anën tjetër, ne nuk e përdorim matematikën prandaj kemi problem me të.”


- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me komunitet jo-shumicë



3.5 A ka dallime gjinore në fushat e preferuara për studim?

Rreth gjysma e nxënësve raportuan se kishin vendosur se çfarë duan të studiojnë në universitet, ndërsa gjysma tjetër raportuan se ose po mendonin ende për këtë, ose ende nuk kishin ende ide konkrete për planet/studimet e tyre të ardhshme. Statistikisht, më shumë vajza raportuan të kenë vendosur për fushat e tyre të ardhshme të studimit në krahasim me djemtë.


Figura 10. Vendimet e studentëve për studimet e ardhshme, sipas gjinisë (%)



Burimi: LEAP, Korrik 2018

Në mesin e grupeve të ndryshme etnike, përqindja më e lartë e nxënësve që kishin vendosur për fushën e tyre të studimit ishin serbët (68.8%), pasuar nga studentët shqiptarë (51.3%). Përsëri, përqindjet më të ulëta ishin në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Figura 11. Zgjedhjet në karrierë sipas gjinisë (%)



Burimi: LEAP, Korrik 2018

Shënim: Ata që kanë zgjedhur opsionin “Tjetër” kanë shprehur dëshirë që të ndjekin një karrierë në Ushtri apo Siguri, ose kanë specifikuar profesione si pilot/e, stomatolog/e dhe prodhues/e.

Nxënësit të cilët kishin vendosur, ose ende ishin duke menduar për fushën e tyre të studimit, u kërkuan që të rrethojnë fushën e tyre të zgjedhur/të preferuar të studimit nga një listë me fusha të studimit siç shihet në Figurën 11. Pasi që një pjesë e madhe e nxënësve vinin nga shkolla profesionale, nuk është për t’u habitur se Edukimi Profesional ishte ndër opsionet më të preferuara të tyre (11.5%), pasuar nga Mjekësia (10%) dhe Shkencat Kompjuterike (8.7%).


Përsa i përket dallimeve gjinore, rezultatet e anketës treguan se djemtë zgjedhin më shumë fusha që zakonisht kërkojnë aftësi matematikore dhe/ose që i pozicionojnë më mirë në tregun e punës, të tilla si Shkenca Kompjuterike, Ekonomi dhe Ndërtimtari; dhe/ose që përputhen me “tiparet e tyre mashkullore” të tilla si Kultura Fizike dhe Bujqësia.

Vajzat në anën tjetër kanë zgjedhur fusha që përshijnë më pak aftësi matematikore dhe më shumë aftësi verbale siç janë Gjuhët; dhe/ose profesione që përputhen me “natyrën e përkujdesjes ndaj të tjerëve” siç janë Mjekësia, Edukimi dhe Psikologjia. Ky dallim gjinor është i pranishëm edhe kur nxënësit u pyetën për fushën e tyre të dytë më të preferuar, d.m.th cila do ishte zgjedhja e tyre e dytë nëse nuk do të pranoheshin në drejtimin që e preferonin më së shumti. Edhe këtu, vajzat preferuan më shumë Edukimin, Psikologjinë dhe Mjekësinë, ndërsa djemtë preferuan Shkencat Kompjuterike dhe Bujqësinë.

Përgjatë vijave etnike, Mjekësia ishte fusha më e preferuar për shumicën e grupeve etnike (shqiptarët, serbët, turqit dhe boshnjakët). Për studentët shqiptarë, fushat tjera më të preferuara të studimit ishin Edukimi Profesional dhe Shkencat Kompjuterike, ndërsa Gjuhët preferoheshin më shumë nga egjiptianët, serbët dhe boshnjakët.

Arsyet pse rinia në Kosovë preferon fusha të caktuara të studimit janë renditur në Figurën 12. Faktori kryesor që u jep kahje zgjedhjeve në karrierë të të rinjve kosovarë është “preferenca për të studiuar atë fushë” (75%); e ndjekur nga “përputhja me personalitetin” (35%) dhe “mundësia për të gjetur punë në të ardhmen” (27%). Djemtë ishin më të përqendruar në fushat e studimit të cilat do t’i poziciononin mirë në tregun e punës: paguhen mirë, do t’ua bënin të lehtë gjetjen e një vendi të punës, dhe do kërkohej në të ardhmen. Për dallim nga djemtë, vajzat ishin më të përqendruara në fushat e studimit që përputheshin me preferencat e tjerëve (zgjedhjet e miqve më të mirë) dhe që përputheshin me tiparet e tyre të personalitetit.

Figura 12. Arsyet për zgjedhjen e një fushe studimi sipas gjinisë (%)



Burimi: LEAP, Korrik 2018.

Shënim: të anketuarit mund të zgjedhnin më shumë se një opsion.

Testet statistikore (ANOVA) tregojnë se ka lidhmëri midis notave dhe zgjedhjeve të studenëve në karrierë. Për shembull, vajzat që vendosin të studiojnë Mjekësi në mesatare raportojnë nota më të larta (sukses përfundimtar) në klasën e 5-të dhe të 10-të krahasuar me vajzat që zgjedhin ndonjë fushë tjetër të studimit (klasa e 5-të: $t = -3.5665$; Klasa e 10-të: $t = -4.9132$). Vajzat me nota më të ulëta preferojnë fusha si Edukimi, Psikologjia ose Gjuhët. Ashtu siç pritej, vajzat që vendosin të studiojnë Shkenca Kompjuterike në mesatare raportojnë nota më të larta në matematikë krahasuar me vajzat që zgjedhin ndonjë fushë tjetër dhe ky dallim është statistikiisht signifikant (klasa e 10-të: $t = -2.7801$); sidoqoftë, për djemtë që vendosin të studiojnë Shkenca Kompjuterike, dallimi mes notave në matematikë nuk është statistikiisht signifikant ($t = -0.9628$).

3.6 Roli i prindërve në zgjedhjet e nxënësve në karrierë: a ka paragjykime gjinore?

Roli i prindërve në vendimet e nxënësve për karrierën e tyre të ardhshme del të jetë thelbësor. Nxënësit raportuan se këshillohen shpesh me prindërit e tyre kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve për karrierë. Në shkallën nga 1 = kurrë deri në 5 = shumë shpesh, rezultati mesatar nga mostra totale ishte 3.98. Sipas gjinisë, vajzat ishin dukshëm më të hapura për t'u këshilluar me prindërit dhe, në përputhje me këtë, deklarojnë më shumë sesa djemtë që "sugjerimet e prindërve për studimet e ardhshme përputhen me planet dhe ëndrrat e tyre për të ardhmen.

Rezultatet nga diskutimet në fokus grupe konfirmuan që familja në përgjithësi, dhe prindërit në veçanti, luajnë një rol kyç në vendimet e nxënësve. Sidoqoftë, pjesëmarrësit ndanë përvoja të ndryshme në këtë aspekt pasi disa raportuan të kenë pasur vetëm diskutime dhe konsultime me prindërit, ndërsa disa të tjerë kishin përjetuar ndërhyrje direkte nga ana e prindërve në planet e tyre për të ardhmen. Në përgjithësi, vajzat raportuan se ndikimi i familjes ishte vendimtar për zgjedhjet e tyre në karrierë dhe se në shumë raste ky ndikim kishte paragjykime gjinore (Kutia 2).

Përveç sygjërimeve dhe ndërhyrjeve të prindërve, rol të rëndësishëm për zgjedhjet në karrierën e nxënësve ka pasur edhe vetë profesioni i prindërve të tyre. Në të gjitha diskutimet e fokus grupeve kishte pjesëmarrës që konfirmuan se profesionet e prindërve të tyre kanë ndikuar në vendimin e tyre për zgjedhjet në karrierë. Më konkretisht, shumica e pjesëmarrësve nga fokusi grupi veçmas me vajza treguan se profesioni i prindërve të tyre ka ndikuar në zgjedhjen e profesionit të tyre të ardhshëm. Për disa nga këto vajza, profesioni i nënës së tyre kishte bërë që edhe ato të duan të zgjedhin të njëjtin profesion (p.sh., mjekë, infermiere ose rrobaqepëse). Anëtarët nga fokus grupet me komunitetet e jo-shumicë raportuan të jenë qenë më pak të ndikuar nga profesioni i prindërve të tyre në zgjedhjet e tyre në karrierë.

Derisa prindërit dhe familja ishin faktorë të rëndësishëm në proceset e vendimmarrjes së studentëve gjatë zgjedhjes së një profesioni, qendrat për këshillim në karrierë në anën tjetër kishin rol të kufizuar në këtë drejtim. Në përgjithësi, vetëm 21% e studentëve konfirmuan se kishin marrë këshilla nga këto qendra. Pjesa tjetër e të anketuarve (rreth 79%) nuk kishin marrë ndonjë këshillë nga këto qendra ose nuk kishin dëgjuar kurrë për to. Për ata që kishin marrë këshilla, del se ato këshilla ishin të dobishme pasi që të anketuarit raportuan nivele të kënaqësisë me mesatare 3.85, nga një shkallë prej 1 = aspak e dobishme deri në 5 = shumë e dobishme. Përsa i përket përkatësisë etnike, serbët raportuan nivelin më të lartë të marrjes së këshillave nga këto qendra kurse niveli më i ulët i marrjes së këshillave u raportua në mesin e nxënësve shqiptarë. Kjo gjetje sugjeron se, edhe pse roli i qendrave për udhëzim të karrierës duket të jetë i kufizuar në përgjithësi, ato janë veçanërisht të dobishme për grupet e pakicave etnike.



Kutia 2. Ndikimi i familjes

“Të gjithë ishin kundër duke thënë se një profesion në tregun e patundshmërive nuk është i përshtatshëm për mua sepse duhet t’i di dredhitë që përdorën në këtë treg, dhe se unë nuk jam person i tillë. Më është thënë se jam shumë e “butë” si person dhe një profesion si infermiera do më lejonte t’i ndihmoj njerëzit.”

-Pjesëmarrëse nga grupi me vajzat nga komuniteti shqiptar

“Unë doja të bëhesha kuzhinierë dhe të hapja restorantin tim në të ardhmen por askush në familjen time nuk ka mbështetur këtë vendim. Doja të shkoja në shkollë bujqësore sepse ofronte studim në kuzhinieri por babai im nuk më lejoi sepse nuk donte që unë të humbja potencialin tim në lëndë tjera, kështu që jam inkurajuar të studioj diçka tjetër.”

– Pjesëmarrëse nga grupi me vajzat nga komuniteti shqiptar

“Prindërit e mi ishin arsyeja kryesore përse kam studiuar mjekësi në shkollë të mesme. Ata dëshironin të shihnin që po ia dilja mirë në jetë, në pozitë sociale dhe në përfitime financiare.”

- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Unë gjithmonë kam dashur të studioj mjekësinë por prindërit nuk më kanë mbështetur edhe aq shumë sepse mendonin se nuk do të kisha kohë të merresha me punët e mia personale”

- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Menaxhim biznesi. Mendoj që gjithmonë kam qenë i orientuar nga biznesi. Asnjëherë nuk më kanë pëlqyer gjërat që janë limituese. Më pëlqen të jem i përfshirë në shumë gjëra njëkohësisht.”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Ende nuk jam në universitet por do të studioj shkenca kompjuterike. Kam vendosur të studioj këtë fushë për shkak të natyrës evolutive të teknologjisë dhe dashurisë sime për të.”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Ka dy lloje prindërisht: ata që përkrahin vendimet e fëmijëve të tyre dhe ata që i sforcjnë preferencat e tyre mbi fëmijët e tyre”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me komunitetet pakicë

“[...]jo shumë prej neve mund të komunikojmë me prindërit tonë për zgjedhjet në karrierë dhe shumë nga ne kanë mbetur prapa në shkollim”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me komunitetet pakicë



3.7 A ka stereotipe gjinore për profesione specifike?

Rezultatet nga anketimi treguan se rreth 60 përqind e të rinjëve kosovarë pajtohen që më shumë gra punojnë si infermiere dhe më shumë burra punojnë si specialistë të teknologjisë informative. Një perspektivë më interesante morrëm nga grupi i pyetjeve normative “kush duhet të punojë” në profesione të caktuara. Në këtë pjesë, ne identifikuan dallime gjinore në perceptimet e rinisë në Kosovë mbi rolin e grave dhe burrave në profesione të caktuara. Djemtë treguan qëndrime më stereotipike pasi ata priren të pajtohen më pak sesa vajzat që “burrat dhe gratë [duhet të punojnë] në mënyrë të barabartë”, në profesionet si specialistë të teknologjisë informative, inxhinierë elektrik dhe arkitektë. Përkundrazi, ata i perceptojnë këto profesione më shumë si profesione mashkullore dhe pajtohen më shumë sesa vajzat me idenë se “më shumë burra” duhet të punojnë në këto tre fusha. Po ashtu, kur bëhet fjalë për profesionet e dominuara nga gratë, si infermiera, mësimdhënia në shkollë fillore dhe arkëtaria, djemtë përsëri pajtohen më shumë sesa vajzat që “më shumë gra” duhet të punojnë në këto tre profesione.

Hulumtimi kualitativ shqyrtoi më tej përse sektori i teknologjisë informative (IT-së) konsiderohet më pak i përshtatshëm për vajzat dhe çfarë mund të bëhet për ta ndryshuar atë. Për disa pjesëmarrës, arsyeja kryesore për këtë dallim ishte për shkak të ndarjes së roleve në familje pasi që burrat tradicionalisht kanë siguruar bukën në familje dhe rrjedhimisht pritet që ata të zgjedhin profesione që u ofrojnë atyre fitime më të mëdha financiare, ndërsa “gratë kanë tendencë të kërkojnë profesione fleksibile që i lejojnë ato të kenë jetë personale dhe të krijojnë familje”. Faktorët tjerë u lidhën me natyrën e vajzave, ku disa pjesëmarrës përmenden faktin që djemtë janë të ekspozuar ndaj teknologjisë qysh në fëmijëri përmes lojërave elektronike, ndërsa vajzat luajnë me kukulla dhe mësojnë se si të kujdesen për to. Disa pjesëmarrës tjerë gjithashtu përmendën se grave u mungon vetëbesimi për të hyrë në këtë sektor (Kutia 3).



Kutia 3. Gjinia dhe sektori i Teknologjisë dhe Informatikës (IT)

“Kjo ndodh për shkak se nuk kemi parë shumë gra që punojnë në sektorin e IT-së në Kosovë prandaj nuk jemi të mësuar me këtë fakt.”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me komunitetet tjera pakicë

“Deri tani është pritur që burrat të jenë fitimprurësit e familjes. Burri është kujdesur për detyrat dhe obligimet jashtë shtëpisë. Si rezultat, burrat janë më të nxitur që të arrijnë sukses sepse duhet të kujdesen për familjet.”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzera nga komuniteti shqiptar

“Është më shumë çështje karakteri. Jo shumë gra u kushtojnë vëmendje pjesëve të kompjuterit. Si rezultat, jo shumë gra janë të interesuara. Burrat janë më të ekspozuar ndaj teknologjisë për shkak të lojërave.”

- Pjesëmarrëse nga grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Ne duhet t’u tregojmë njerëzve të dhënat dhe t’u tregojmë që sektori i IT-së është vazhdimisht duke kërkuar punëtorë pavarësisht a janë gra apo burra”.

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me komunitetet tjera pakicë

“E njoh një grua që është lidere e një kompanie në IT. Ajo është gruaja më e fortë që njoh dhe është shembull për mua. Në mënyrë që të inkurajojmë më shumë gra të studiojnë në këtë fushë, gratë e suksesshme në këtë industri duhet t’i ndajnë eksperiencat e tyre dhe t’i inkurajojnë gratë të studiojnë këtë fushë.”

- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me gjini të përzera nga komuniteti shqiptar

“Ndoshta me një tregim relevant... diçka interesante.”


- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me komunitet



Krahasimet midis perceptimeve të nxënësve mbi profesionet specifike për një gjini dhe perceptimeve për shpërndarjen gjinore aktuale në profesione të ndryshme, treguan se rezultatet janë shumë të ngjashme. Kjo do të thotë se, për shumicën e pjesëmarrësve në studim dhe pavarësisht gjinisë, perceptimet për rolet dhe profesionet normative gjinore formësohen nga mënyra se si ata perceptojnë aplikimin e këtyre normave në tregun ekzistues të punës i cili është i ndarë në baza gjinore, të cilat perceptime mëpastaj mund të ndikojnë zgjedhjet në karrierë të rinjve në Kosovë. Kjo është portretizuar qartë në Figurën 13: më shumë djem ishin të pajtimit se një karrierë në “arkitekturë”, “inxhinieri elektrike” dhe “teknologji informative” do të përputhej me vlerat e tyre, dhe se do të ishin të aftë të ndiqnin një karrierë në këto tre fusha. Në anën tjetër, më shumë vajza ishin të pajtimit që një karrierë në “mësimdhënie në shkollë filllore” ose “infirmieri” do të përputhej me vlerat e tyre dhe se do të ishin më të afta të ndiqnin me sukses një karrierë në këto profesione. Përsa i përket vlerave më të larta dhe më të ulëta të mesatareve në vetë-perceptimin e të intervistuarve mbi aftësitë e tyre për të ndjekur me sukses një karrierë, djemtë raportuan mesataren më të lartë në ndjekjen e një karriere si specialist të teknologjisë informative (mesatarja = 3.35) ndërsa mesatarja më e lartë për vajza ishte ndjekja e një karriere për mësimdhënie në shkollë filllore (mesatarja = 3.68). Këto rezultate ishin në vijë me vetë-perceptimet e të anketuarve mbi “përputhjen e vlerave” me profesione të caktuara.

Vajzat raportuan mesataren më të lartë në deklaratën se “Profesioni i mësuesit/es në shkollë fillore përputhet me vlerat e mia” ndërsa djemtë raportuan mesataren më të lartë në deklaratën se “Profesioni i specialistit/es së teknologjisë informative (sektori i ICT) përputhet me vlerat e mia”. Në anën tjetër, vajzat raportuan që ndjeheshin më pak të afta për të ndjekur me sukses një karrierë si inxhinierë elektrike (mesatarja = 2.54) ndërsa djemtë raportuan se ndiheshin më pak të aftë për të ndjekur me sukses një karrierë në “infirmieri” (mesatarja = 2.59). T-testet treguan se, përveç profesionit “arkëtar/e” dhe “arkitekt/e”, mesataret e dallimeve gjinore për katër profesionet tjera ishin të rëndësishme (të gjitha vlerat e $p < 0.01$).

Figura 13. Perceptimet mbi rolet gjinore: STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) kundrejt HEED (Shëndetësia, Edukimi i Hershëm dhe Rolet Shtëpiake)



Burimi: LEAP, Korrik 2018; Shkalla: 1=nuk pajtohem aspak deri 5=pajtohem plotësisht
 Shënim: Të gjitha dallimet të rëndësishme janë shënuar me yll (*)

Në hulumtimin kualitativ shqyrtuam më tej dallimet gjinore në lidhje me vlerat profesionale, d.m.th, shkallën në të cilën përfitimet financiare; pushteti; dhe mundësia për të ndihmuar tjerët u japin kahje zgjedhjeve të studentëve në karrierë. Kutia 4 thekson disa pjesë nga ky diskutim bazuar në përkatësi etnike dhe gjini.

Rezultatet nga hulumtimi kualitativ konfirmuan se vajzat i kushtojnë më shumë rëndësi mundësisë për t'i ndihmuar të tjerët në zgjedhjen e një profesioni sesa djemtë. Nga fokus grupi i organizuar veçmas me vajza, vetëm njëra nga pjesëmarrëset shprehu më shumë preferencë për profesionet që do i ofronin siguri financiare. Të gjithë anëtarët tjerë të këtij grupi (d.m.th., vajzat) argumentuan se **është më e rëndësishme të zgjedhin një profesion përmes së cilit do të mund të ndihmonin tjerët**. Sidoqoftë, në fokus-grupin e përzier gjinor, vajzat besonin se të ndihmuarit e tjerëve dhe arritja e statusit në shoqëri nuk duhet të jenë përjashtuese njëra me tjetrën. Djemtë në anën tjetër u shprehën se është më e rëndësishme për ata që të arrijnë një status në shoqëri dhe/ose të kenë siguri financiare kur zgjedhin një profesion (shihni Kutinë 4). Përsa i përket dallimeve etnike, fitimi i pushtetit/fuqia ishte më e rëndësishme për djemtë nga komuniteti serb, ndërsa siguria financiare ishte më e rëndësishme për djemtë e komunitetit shqiptar.



Kutia 4. Gjinia dhe Vlerat e Profesionit: siguria financiare; statusi në shoqëri, mundësi për të ndihmuar tjerët

“Më pëlqente shumë mjekësia sepse do të mund të ndihmoja njerëzit por, për shkak të natyrës time sensitive, nuk mund ta zgjedhja atë. E vlerësoj humanizimin më shumë se përfitimin personal”

- Pjesëmarrëse nga fokus grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Do të doja të ndihmoja të tjerët sepse më bën të ndihem mirë, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të kesh fitim financiar nga profesionet që ndihmojnë njerëzit”

- Pjesëmarrëse nga fokus grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Unë po ashtu vlerësoj humanizmin para fitimeve personale pasi që ne merremi me njerëz gjithë kohën dhe përse të mos u ndihmojmë atyre”

- Pjesëmarrëse nga fokus grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“Jam shumë sensitive dhe e vlerësoj njerëzoren më shumë sesa përfitimet financiare. Ndiheh më mirë kur bën aktivitete humanitare”

- Pjesëmarrëse nga fokus grupi me vajza nga komuniteti shqiptar

“E kam shumë të vështirë të besoj që dikush zgjedh një profesion me të vetmen arsye që të ndihmojë tjerët.”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Për mua si dizajner grafik, përfitimet financiare janë më të rëndësishme”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Për mua si programer, është e rëndësishme që para së gjithash të kem përfitime financiare përmes profesionit tim”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Kam vullnet të ndihmoj tjerët vetëm nëse kam llogari të bëj një gjë të tillë. Dua të kujdesem se pari për veten dhe të siguroj stabilitet financiar dhe pasuri, dhe pastaj t’u jap të tjerëve nëse jam në pozitë për të vepruar ashtu”

- Djalë pjesëmarrës nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“[...] sigurisht ka marrëdhënie reciproke mes ndihmës së të tjerëve dhe të ardhurave financiare”

- Vajzë pjesëmarrëse nga grupi me gjini të përzier nga komuniteti shqiptar

“Do të zgjedhja profesionin përmes të cilit do të mund të ndihmoj të tjerët.”


- Vajzë pjesëmarrëse nga fokus grupi me komunitetet tjera jo-shumicë


“Mendoj që të dyjat, por së pari të fitoj status pastaj të ndihmoj tjerët.”

- Djalë pjesëmarrës nga fokus grupi me komunitetet tjera jo-shumicë



Zgjedhjet në karrierë bëhen në bazë të **besimeve stereotipike** për përputhjet gjinore me profesionin e ardhshëm: vajzat preferojnë profesione të tilla si Mjekësia, Edukimi dhe Psikologjia të cilat kërkojnë më pak aftësi matematikore dhe reflektojnë më shumë vlera **"të orientuara nga ndihma"**; ndërsa djemtë preferojnë profesione si Shkencat Kompjuterike, Kultura Fizike dhe Bujqësia të cilat kërkojnë **më shumë aftësi matematikore** dhe duket se përshtaten më mirë me **tiparet e perceptuara mashkullore**.





4: Përmbledhje e Gjetjeve të Hulumtimit

Ky studim hulumton marrëdhëniet midis zgjedhjeve në karrierë dhe stereotipeve gjinore në mesin e të rinjve në Kosovë. Specifikisht, studimi analizon faktorët që shpjegojnë zgjedhjet në karrierë të nxënësve në tre aspekte: performancën e nxënësve në shkollë dhe vetë-konceptin akademik; konsultimet e nxënësve me prindërit/familjen/qendrat për këshillim në karrierë; dhe perceptimet e nxënësve mbi profesionet specifike për gjini dhe rolet gjinore në shoqëri në përgjithësi.

Studimi përfshin një anketim mbarëkombëtar (N = 1,050) me djem dhe vajza në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10 dhe 11) dhe katër fokus grupe me nxënës nga shkolla të mesme dhe studentë universiteti të vitit të parë nga fakultetet e shkencave sociale dhe shkencave natyrore.

Të përmbledhura, gjetjet kryesore të hulumtimit janë si vijojnë:

- **Vajzat kanë raportuar të kenë nota më të mira se djemtë përgjatë gjithë viteve të shkollimit.** Në përputhje me performancën e tyre të përgjithshme akademike, vajzat raportuan të kenë performancë akademike më të lartë në matematikë, dhe edhe më të lartë në gjuhë, krahasuar me djemtë të cilët kanë vetë-raportuar mesatare më të ulëta për performancën e tyre akademike.

- **Megjithatë, ekziston një mospërputhje mes performancës së vetë-raportuar nga vajzat dhe perceptimit rreth aftësive të tyre akademike.** Në mesatare, vetë-perceptimi i vajzave për aftësitë e tyre në matematikë është më i ulët sesa notat e vetë-raportura përgjatë arsimit të mesëm të lartë. Këto gjetje përsërisin gjetjet e mëhershme nga vendet e tjera ku aftësia matematikore e vetë-raportuar nga vajzat është gjetur të jetë më e ulët sesa performanca e tyre aktuale në këtë lëndë (shihni Weinhardt, 2017). Kjo sugjeron që vajzat janë veçanërisht të prirura t'i perceptojnë aftësitë e tyre në matematikë si më të ulëta sesa janë në të vërtetë.

- **Ka indikacione për praninë e "kërcënimit nga stereotipi" në mesin e vajzave në përgjithësi.** Në krahasim me djemtë, vajzat kanë raportuar se kanë nota më të mira në matematikë por megjithatë ato raportojnë që kanë shumë stres gjatë testeve të matematikës ose që janë më të brengosura për notën e tyre përfundimtare në matematikë. Hulumtimi kualitativ nxjerrë në pah se vajzat ishin gjithashtu më të hapura për t'i diskutuar këto pengesa kur ishin në fokus grup të përbërë vetëm nga vajzat, gjë që sugjeron se kur identiteti i tyre gjinor nuk paraqet problem, vajzat mund të flasin hapur për shqetësimet e tyre në krahasim me grupet e përziera gjinore në të cilat ato kanë tendencë t'i minimizojnë këto efekte. Për shumicën e pjesëmarrësve nga grupet e tjera, testet e matematikës nuk ishin aq stresuese për dy arsye, ose për shkak se ata/ato ishin të mirë/a në matematikë, ose sepse nuk i kushtonin shumë kohë dhe nuk e konsideronin atë si një lëndë të rëndësishme.

- **Rezultatet poashtu treguan dallime signifikante në mesin e grupeve etnike në perceptimet mbi vetë-aftësitë.** Vetë-aftësia më e lartë në matematikë u raportua në mesin e studentëve turq dhe më e ulëta u raportua në mesin e komunitetit goran, rom, egjiptian dhe ashkali. Po ashtu, derisa mesatarja totale e aftësisë së vetë-raportuar në gjuhë ishte më e lartë për të gjithë mostrën (3.98), më e ulëta raportohet të ishte në mesin e komunitetit ashkali. Kjo gjetje sugjeron se, ngjajshëm me vajzat si një grup i stigmatizuar që nuk performon mirë në matematikë, anëtarët e grupeve etnike rëndom të stigmatizuara në Kosovë siç janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë efektet e “kërcënimit nga stereotipi” në arritjet akademike (Steele & Aronson, 1995).

- **Vajzat dhe djemtë në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë shfaqën preferenca stereotipike gjinore për lëndët shkollore dhe profesionet e ardhshme.** Lëndët më të preferuara nga vajzat janë Gjuhët, Kimia, Biologjia dhe Psikologjia ndërsa lëndët më të preferuara nga djemtë janë Informatika, Kultura Fizike dhe Gjeografia.

- Në kontekstin e dallimeve etnike, pavarësisht nga gjinia, gjetjet kualitative treguan se **gjuha angleze është ndër lëndët më të preferuara për shqiptarët dhe komunitetet e tjera jo-shumicë përveç serbëve**, të cilët favorizuan gjuhët serbe dhe ruse. Edhe pse nuk është matur në mënyrë specifike në këtë studim, kjo gjetje mund të shpjegohet si strategji e mbrojtjes ndaj kërcënimit potencial për identitetin etnik që mund të ndjejnë serbët në Kosovë. Për shkak të kësaj, vlerësimi i gjuhës së tyre mund të jetë një mënyrë e ballafaqimit me këtë kërcënim dhe me ndjesinë e humbjes potenciale të identitetit që serbët si pakicë etnike mund të kenë (shihni Maloku, Derks, Van Laar, & Ellemers, 2018, për detaje mbi identitetin në Kosovë).

- **Më e rëndësishmja del se zgjedhjet në karrierë bëhen në bazë të besimeve stereotipike për përputhjet gjinore me profesionin e ardhshëm:** vajzat preferojnë profesione të tilla si Mjekësia, Edukimi dhe Psikologjia të cilat kërkojnë më pak aftësi matematikore dhe reflektojnë më shumë vlera “të orientuara nga ndihma”; ndërsa djemtë preferojnë profesione si Shkencat Kompjuterike, Kultura Fizike dhe Bujqësia të cilat kërkojnë më shumë aftësi matematikore dhe duket se përshtaten më mirë me tiparet e perceptuara mashkullore.


- Notat janë të rëndësishme për zgjedhjet në karrierë. **Vajzat që preferojnë të studiojnë Mjekësi raportuan sukses të përgjithshëm më të lartë në klasën e 5-të dhe të 10-të krahasuar me vajzat që zgjedhin ndonjë fushë tjetër të studimit.** Siç pritej, **vajzat që preferojnë të studiojnë Shkenca Kompjuterike raportojnë nota konsiderueshëm më të larta në matematikë.** Për dallim nga vajzat, dallimet mes djemve që preferonin Shkencat Kompjuterike kundrejt atyre që preferonin fushat e tjera të studimit nuk ishin signifikante.

- **Roli i prindërve në vendimet e nxënësve është thelbësor.** Rezultatet kuantitative dhe kualitative treguan se familja në përgjithësi, dhe prindërit në veçanti, luajtën një rol të madh në vendimet e nxënësve. Vajzat ishin dukshëm më të hapura për të kërkuar konsultime me prindërit në krahasim me djemtë. Njëkohësisht, ato ishin më të ndikuara që të veprojnë sipas sugjerimeve të prindërve në krahasim me djemtë. **Ndikimi i prindërve në këto vendime ka paragjykime gjinore:** vajzave shpesh u thuhet të zgjedhin një profesion që u ofron më shumë siguri në punësim por që gjithashtu u siguron kohë të lirë për të krijuar familje dhe për të rritur fëmijë. Për dallim, djemtë këshillohen të zgjedhin karrierën dhe profesionin e tyre bazuar në mundësitë e tregut të ardhshëm të punës. Siç mund të pritet, pavarësisht gjinisë, **përgatitja profesionale e prindërve gjithashtu ndikon në këshillat që ata u japin fëmijëve të tyre.**

- Kur zgjedhin një profesion, vajzat u kushtojnë më shumë rëndësi sesa djemtë profesioneve që bazohen në vlerat e “ndihmës” ose fokusohen në “njerëz”. Vajzat preferuan më shumë lloje të profesioneve që u lejojnë atyre të “ndihmojnë tjerët” dhe të “kujdesen për tjerët”. Në anën tjetër, shumica e djemve preferuan profesione që do t’u siguronin atyre status/pushtet në kontekstin shoqëror dhe pavarësi financiare.

- Perceptimet e studentëve se “kush duhet të punojë” në profesione/punë stereotipike në tregun e punës janë reflektim i përfaqësimit aktual gjinor të personave “që tashmë punojnë” në këto lloje profesionesh/punësh. Djemtë konsiderojnë se profesionet në STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) përputhen me vlerat e tyre dhe e perceptojnë veten si të aftë për të ndjekur me sukses një karrierë në këto fusha. Në anën tjetër, vajzat e perceptojnë veten si më të afta dhe më të përshtatshme për profesionet në fushën e HEED (Shëndetësia, Edukimi i Hershëm dhe Rolet Shtëpiake). Më konkretisht, djemtë e perceptojnë veten si më të përshtatshëm për të punuar si “specialist i teknologjisë informative” ndërsa vajzat besojnë se ato janë më të përshtatshme për “të dhënë mësim në shkollë fillore”.

Gjetjet nga ky studim tregojnë se stereotipet gjinore ndikojnë në zgjedhjet në karrierë të të rinjve në shkollat e mesme të Kosovës dhe se ekziston një dallim i qartë gjinor në preferencat për fushat e studimit **STEM** kundrejt atyre **jo-STEM**. Në të vërtetë, zgjedhjet në karrierë të raportuara nga vajzat dhe djemtë konfirmojnë dallimet aktuale gjinore në tregun e punës dhe në pozitat udhëheqëse në shoqërinë kosovare. Të marra së bashku, gjetjet e këtij studimi tregojnë se zgjedhjet në karrierë të bëra nga vajzat dhe djemtë **janë të ndikuara fuqishëm nga normat dhe vlerat shoqërore.**





5: Përfundimet dhe Rekomandimet

Në përgjithësi, ky studim gjen që vajzat e reja nga një mostër përfaqësuese e shkollave të mesme të Kosovës raportojnë performancë më të lartë akademike në krahasim me djemtë. Megjithatë, atyre u mungon vetëbesimi për aftësitë e tyre në fushat e STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë): ato shprehin vetë-perceptim akademik më të ulët sesa performanca e tyre aktuale dhe raportojnë se përjetojnë më shumë stres dhe ankth gjatë testeve të matematikës. Mund të argumentohet se këto rezultate burojnë nga mbizotërimi i stereotipeve negative se “vajzat thjesht nuk janë të mira në matematikë”. Është diskutuar në literaturë se të qenit i vetëdijshëm/e vetëdijshme për stereotipe të tilla shkakton “kërcënim nga stereotipi” përmes të cilit anëtarët e grupeve të stigmatizuara shpesh performojnë më keq sepse janë të vetëdijshëm për stereotipet negative që ekzistojnë për grupet e tyre (p.sh. kur ekzistojnë stereotipe negative për gratë, anëtarët e grupeve pakicë etj.). Ky efekt negativ vazhdon të jetë prezent tek vajzat edhe në preferencat e tyre për karrierë dhe në zgjedhjet që bëjnë në arsimin e lartë. Për dallim nga djemtë, vajzat e shkollave të mesme në Kosovë preferojnë më shumë lëndë shkollore që përfshijnë më pak aftësi/përgatitje matematikore dhe zgjedhin fusha jo-STEM gjatë arsimit të lartë. Megjithatë, vajzat që preferojnë të studiojnë fushat që perceptohen si “të vështira” siç janë Mjekësia ose Shkencat Kompjuterike, raportojnë nota më të larta në vitet e mëparshme të shkollimit. Vajzat gjithashtu preferojnë më shumë lloje të profesioneve që bazohen në sistemin e vlerave të “ndihmës për të tjerët” krahasuar me djemtë që shkojnë më shumë pas profesioneve që u përshtaten “tipareve të tyre mashkullore”. Vajzat gjithashtu janë më të ndikuara dhe duket se veprojnë më shumë sipas sugjerimeve të prindërve, motrave, vëllezërve dhe miqëve, në krahasim me djemtë.

Gjetjet nga ky studim tregojnë se stereotipet gjinore ndikojnë në zgjedhjet në karrierë të të rinjve në shkollat e mesme të Kosovës dhe se ekziston një dallim i qartë gjinor në preferencat për fushat e studimit STEM kundër atyre jo-STEM. Në të vërtetë, zgjedhjet në karrierë të raportuara nga vajzat dhe djemtë konfirmojnë dallimet aktuale gjinore në tregun e punës dhe në pozitat udhëheqëse në shoqërinë kosovare. Të marra së bashku, gjetjet e këtij studimi tregojnë se zgjedhjet në karrierë të bëra nga vajzat dhe djemtë janë të ndikuara fuqishëm nga normat dhe vlerat shoqërore.

Përveç efekteve të besimeve stereotipike gjinore, rezultatet tregojnë edhe një gjetje tjetër të rëndësishme për mënyrën se si grupet e caktuara etnike janë gjithashtu të stereotipizuara dhe/ose vetë-stereotipizuara. Këto gjetje tregojnë se performanca e dobët akademike dhe vetë-perceptimi i ulët i aftësive janë veçanërisht të theksuara në mesin e grupeve etnike rëndom të stigmatizuara siç janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Në përgjithësi, këto komunitete raportojnë se përbëjnë jo vetëm pjesën më të madhe të nxënësve me performancë më të ulët në lëndët e matematikës dhe gjuhës, por gjithashtu raportojnë të kenë vetë-perceptimet më të ulëta për aftësi në këto lëndë.

Për të mbështetur dhe rritur angazhimin e vajzave në edukimin STEM, rekomandimet e mëposhtme u propozohen palëve të interesuara në edukim në nivel qendror dhe lokal:

1. T'u ofrohen vajzave të shkollave të mesme informatike të targetuara dhe lehtë të përdorueshme për rëndësinë e edukimit dhe programeve STEM si dhe mundësitë dhe përfitimet në tregun e punës. Kjo mund të bëhet duke mbledhur dhe shpërndarë informata përmes platformave online, gazetave, broshurave dhe reklamave. Përmes këtyre kanaleve të informimit, të rinjtë e Kosovës, e në veçanti vajzat, mund të mësojnë për profesionet më të kërkuara; rëndësinë e shkollimit STEM; programet aktuale të akredituara në fushat STEM që ofrohen në institucione private dhe publike të arsimit të lartë; kërkesat për aplikim; mundësitë alternative për financim; dhe mundësitë për bursa. Për më tepër, prindërit gjithashtu duhet të targetohen përmes këyre informatave për të rritur vetëdijësimin e tyre mbi ndikimin që kanë tek vajzat e tyre për zgjedhjet në karrierë, dhe për mënyrën se si kjo mund të përdoret më së miri për të pasqyruar aftësitë dhe shkathtësitë e vajzave të tyre dhe jo bindjet stereotipike që bazohen në rolet gjinore në shoqëri. Për shembull, studimet e mëparshme tregojnë se studentët, prindërit e të cilëve ishin të informuar në lidhje me edukimin STEM dhe rëndësinë e tij, kishin më shumë të ngjarë të merrnin më shumë klasa në fushat STEM dhe të ndiqnin një karrierë në STEM (Rozek, Svoboda, Harackiewicz, Hulleman, & Hyde, 2017).

2. Të ofrohen programe të mentorimit me gra të sukseshme dhe rol-modele në fushat STEM. Një tjetër mundësi përmes së cilës vajzat e reja do mund të mësojnë për rëndësinë e edukimit STEM është përmes programeve të mentorimit - takimeve, punëtorive dhe forumeve - me gra të sukseshme në fushat STEM në Kosovë dhe më gjerë. Këto takime do mund të organizoheshin në shkolla të mesme dhe vajzat do të kishin mundësinë të takoheshin dhe të mësonin mbi sukseset dhe arritjet e grave mentore. Për më tepër, programet e mentorimit mund të ofrohen gjithashtu në formën e e-mentorimit ose përmes mundësive të mentorimit online. Pavarësisht nga formati i zgjedhur, programet e mentorimit janë treguar të kenë ndikim pozitiv që rezulton në vlerësim më të lartë të konceptit për veten, në marrjen e vendimeve të orientuara nga STEM dhe në ndryshimin e supozimeve vetë-stereotipizuese me të cilat përballen vajzat e reja kur e perceptojnë veten si jo të përshtatshme për edukim në STEM (Cheryan, Drury, & Vichayapai, 2013; Deaux & Lewis, 1984; Evans, Whigham, & Wang, 1995; Stout, Dasgupta, Hunsinger, & McManus, 2011). Për më tepër, vajzat dhe gratë që zgjedhin të ndjekin një shkollim ose karrierë të orientuar kah STEM gjithashtu kanë theksuar rëndësinë që kanë pasur rol-modelet e sukseshme në proceset e tyre të vendimmarrjes (Eccles, 1987). Prandaj, programet e mentorimit të hartuara mirë janë thelbësore, jo vetëm për sa i përket rritjes së 35 pjesëmarrjes së vajzave në edukimin STEM, por edhe mbajtjes së tyre në këto fusha edhe më vonë gjatë karrierës.

3. Të përforcohen në vazhdimësi raportet ekzistuese të mentorimit me fokus në ngritjen e kapaciteteve për vajzat në STEM. Një marrëdhënie mentorimi mes studentës (të mentorueses) dhe mentores (gratë rol-modele në STEM) do u ofronte mbështetje dhe udhëzim vajzave të reja që dëshirojnë të ndjekin karrierë në STEM. Sipas njohurive tona, një program mentorimi ("Mentorimi i së Ardhmes Tonë") tashmë ekziston për studentë dhe maturan të të Universitetit të Prishtinës. Mirëpo, fokusi i programit është që të mbështesë fuqizimin e studentëve dhe orientimin në karrierë në përgjithësi, dhe nuk ka për qëllim mbështetjen e vajzave në edukimin STEM në veçanti. Një program specifik i mentorimit që synon regjistrimin e vajzave në edukimin STEM është pilotuar nga Qendra LEAP në komunën

e Gjakovës dhe Kamenicës (financuar nga Ambasada Kanadeze). Programet e ardhshme duhet të përshtaten dhe të zgjerohen në komunat tjera në Kosovë, si dhe duhet të jenë të hapura për një program më të larmishëm etnik. Tani për tani, të gjitha mentorët e këtij pilot-programi të mentorimit STEM janë nga komuniteti shqiptar. Në mënyrë që përfitimet nga mentorimi të aplikohen edhe në komunitetet tjera, programet duhet të jenë të larmishme nga aspekti etnik, të cilat do t'u ndihmonin vajzave të reja që të lidhen dhe të identifikohen me gratë rol-modele nga grupi i tyre etnik. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët raportojnë arritjet më të ulëta akademike dhe besimin më të ulët për arritjet e tyre akademike.

4. Të ofrohen bursa për vajzat në STEM duke targetuar të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Programet e bursave mund të tërheqin gra të reja të talentuara në matematikë dhe në fusha që lidhen me shkencë që të vazhdojnë karrierën e tyre në fushat STEM dhe të bëhen specialiste/shkencëtare të suksesshme në të ardhmen. Këto bursa të bazuara në meritë, duhet të targetojnë studentet potenciale nga e gjithë Kosova.

5. Të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi mes prindërve, edukatorëve/mësuesve dhe administratorëve të shkollës për të rritur interesimin dhe performancën e vajzave në fushat STEM. Këto aktivitete mund të organizohen përmes komiteteve prindër-mësues që veç ekzistojnë në shkolla, ose përmes krijimit të organeve të reja në mjediset shkollore në rastet kur ato mungojnë. Përmes këtij bashkëpunimi, arsimtarët dhe administratorët e shkollës mund të marrin një rol më aktiv në takimet me prindër dhe në informimin e tyre për rëndësinë e aktiviteteve shkollore të lidhura me STEM. Paralelisht, vetëdijësimi i prindërve për përfitimet nga edukimi STEM, si dhe aktivitetet konkrete shkollore që synojnë të nxisin ato përfitime, gjithashtu mund të shërbejnë si bazë mbështetëse për interesimet potenciale të vajzave të tyre dhe angazhimin e tyre të ardhshëm në aktivitete të lidhura me STEM siç janë anëtarësimi në klubet STEM, konkurset e matematikës dhe shkencës, etj., (shihni Wiest, 2014; mbi strategjitë që prindërit mund të ofrojnë për të mbështetur vajzat në STEM).

6. Të hartohet "Libër Udhëzues për Prindërit për Planifikim të Karrierës". Hartimi i një libri udhëzues për prindërit, mbi mënyrën se si prindërit mund t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre në zgjedhjet për karrierë, do të lehtësonte procesin e ofrimit të ndihmës nga prindërit, rritjes së vetëdijësimit dhe ndjenjës së eksplorimit në mesin e fëmijëve të tyre, dhe gjithashtu do të inkurajonte të rinjtë (sidomos vajzat) të ndjekin karriera të larmishme. Një udhëzues i tillë duhet të zhvillohet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse përkatëse dhe duhet të mbulojë një sërë temash dhe materialesh për të ndihmuar prindërit në procesin e udhëzimit.

7. Të promovohet një filozofi pedagogjike përmes së cilës materialet shkollore, tekstet shkollore dhe veprimtaritë në klasë hartohen dhe portretizohen në terme gjinore neutrale. Pasi që stereotipet gjinore krijohen që në moshë shumë të re, është thelbësore që fëmijët të mos u ekspozohen aktiviteteve shkollore dhe materialeve që janë stereotipike në portretizimin e një shoqërie me specifika gjinore, dhe në përgjithësi, të një shoqërie patriarkale. Për shembull, materialet ku gratë janë "natyrë e butë" dhe burrat janë "të fuqishëm", ku imazhet e shkencëtarëve janë gjithmonë imazhe tipike të "burrave" ndërsa profesionet për përkujdesje portretizohen nga "gratë", duhet të sillen në vëmendje të mësuesve, prindërve dhe komuniteteve më të gjëra të shkollës. Anipse çështja e portretizimit problematik stereotipik të burrave dhe grave në tekstet shkollore tashmë është ngritur nga një numër i ekspertëve gjinorë në vend, megjithatë përmbajtja e librave shkollore dhe

mentaliteti shkollor nuk ka ndryshuar shumë në këtë drejtim. Prandaj, është me shumë rëndësi që kjo çështje të adresohet përfundimisht nga autoritetet arsimore dhe palët e interesuara në nivelin qendror dhe lokal, përfshirë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Zyrën e Kryeministrit për Barazi Gjinore, Drejtoritë e Arsimit në nivel komunal, administratorët e shkollave dhe mësuesit.

8. Të promovohet dhe mbështetet barazia në nivelin familjar dhe në komunitet. Duke pasur parasysh se besimet stereotipike formësohen qysh herët dhe se normat e kontekstit shoqëror u japin kahje mënyrave se si duhet të sillen anëtarët e secilës gjini, është e rëndësishme që ndryshimet pozitive të adresohen në mënyrë sistematike. Prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm se mënyra se si ata i shohin profesionet me stereotipizim, d.m.th. që i takojnë njëres apo tjetres gjini, luan një rol thelbësor në mënyrën si prindërit ndikojnë tek synimet për shkollim dhe karrierë të fëmijëve të tyre, dhe se ky efekt është veçanërisht i theksuar për vajzat. Aq sa ka mundësi, fushatat për rritjen e vetëdijësimit, shfaqjet televizive dhe aktivitetet në shkollë duhet t'i vetëdijësojnë prindërit për pengesat potenciale që besimet stereotipike u shkaktojnë fëmijëve të tyre në zgjedhjen në karrierës, në arritje dhe në pavarësi financiare në të ardhmen. Në veçanti, prindërit duhet të mësojnë se si të rrisin vetëbesimin e vajzave të tyre dhe si t'i motivojnë ato duke u ngjallur interes në temat që lidhen me STEM. Shkollat gjithashtu duhet të mbështesin këtë rol duke u mësuar fëmijëve, veçanërisht vajzave, aftësitë e të menduarit kritik; duke i mësuar ato të adoptojnë një mentalitet zhvillimi që lejon aftësitë dhe njohuritë e tyre të 37 përparojnë, dhe të largohen nga një mentalitet i caktuar ku fëmijët mësohen të mendojnë për aftësitë dhe shkathtësitë e tyre si statike dhe të pandryshueshme.

9. Të mbahen pritje të larta për vajzat rreth performances së tyre në shkollim dhe karrierë. Kontekstet ku prindërit, mësuesit dhe komunitetet transmetojnë pritje që vajzat të kenë vetëbesim, të jenë aspiruese, të punojnë mirë në projekte shkencore dhe të shkëlqejnë në karrierën e tyre, duhet të nxiten dhe promovohen kudo. Më e rëndësishmja, mbajtja e këtyre pritjeve nuk bie në kundërshtim me qëllimet tjera të orientuara nga familja apo komuniteti. Besimi se vajzat dhe djemtë performojnë njëllë mirë në fushat STEM mund të çojë përfundimisht drejt zvogëlimit të dallimit real që ekziston në këtë drejtim (Wiest, 2014).

Të marra së bashku, këto rekomandime ofrojnë një listë të çështjeve kryesore të ngritura nga studimi i raportuar këtu dhe sugjerojnë hapa konkretë që mund të merren për t'i adresuar ato. Rekomandimet 1 deri 6 adresojnë në mënyrë specifike dallimin gjinor në STEM nga një perspektivë korrektuese, dhe si i tillë zbatimi i tyre mund të hartohet në një planifikim me afat të shkurtë apo të mesëm. Rekomandimet 7 deri 9 adresojnë stereotipet gjinore si konstrukte shoqërore dhe ofrojnë mënyra për të zvogëluar efektet e tyre me një qasje të plotë sistematike që ndihmon në formësimin e qëndrimeve të fëmijëve qysh herët, veçanërisht në mesin e vajzave. Duke pasur parasysh që këto rekomandime janë ndër-sektoriale, hartimi dhe zbatimi i tyre duhet të planifikohet për një kohë të gjatë. Më e rëndësishmja, këto ndërhyrje duhet të jenë të bazuara në gjetje empirike në mënyrë që të mund të prezantohen me saktësi efektivitetin e tyre dhe pengesat e mundshme në plan afatgjatë.

Referencat

- Avlijas S., Ivanovic N., Vladislavljevic M., & Vujic S. (2013). Gender Pay Gap in the Western Balkan Countries: Evidence from Serbia, Montenegro and Macedonia. FREN – Foundation for the Advancement of Economics. ISBN 978-86-916185-1-3. Retrieved from: <http://www.fren.org.rs/sites/default/files/Gender%20pay%20gap%20in%20the%20Western%20balkan%20countries.pdf>
- Bian, L., Leslie, S. J., & Cimpian, A. (2017). Gender stereotypes about intellectual ability emerge early and influence children's interests. *Science*, 355(6323), 389-391. doi: 10.1126/science.aah6524.
- Blackburn, R. M., Jarman, J., & Racko, G. (2014). Occupational segregation: Its vertical and horizontal dimensions. In G. Razzu (Ed.), *Gender inequality in the labour market in the UK* (pp. 101-121). Oxford: Oxford University Press.
- Chamberlain A., & Jayaraman J. (2017). The Pipeline Problem: How College Majors Contribute to the Gender Pay Gap, Glasdoor Economic Research Report. Retrieved from: <https://www.glassdoor.com/research/app/uploads/sites/2/2017/04/FULL-STUDY-PDF-Gender-Pay-Gap2FCollege-Major.pdf>
- Chamberlain A., (2016). Demystifying the Gender Pay Gap: Evidence from Glassdoor Salary Data, Glasdoor Economic Research Report. Retrieved from: <https://www.glassdoor.com/research/app/uploads/sites/2/2016/03/Glassdoor-Gender-Pay-Gap-Study.pdf>
- Cheryan, S., Drury, B. J., & Vichayapai, M. (2013). Enduring influence of stereotypical computer science role models on women's academic aspirations. *Psychology of Women Quarterly*, 37(1), 72-79. <http://dx.doi.org/10.1177/0361684312459328>
- Cheryan, S., Master, A., & Meltzoff, A. N. (2015). Cultural stereotypes as gatekeepers: increasing girls' interest in computer science and engineering by diversifying stereotypes. *Frontiers in psychology*, 6, 49. doi:10.3389/fpsyg.2015.00049
- Cheryan, S., Plaut, V.C., Handron, C., & Hudson, L. (2013), The Stereotypical Computer Scientist: Gendered Media Representations as a Barrier to Inclusion for Women, *Sex Roles*, 69, 58-71, DOI 10.1007/s11199-013-0296-x.
- Deaux, K., & Lewis, L. L. (1984). Structure of gender stereotypes: Interrelationships among components and gender label. *Journal of Personality and Social Psychology*, 46(5), 991-1004.
- Dryler, H. (1998). Parental role models, gender and educational choice. *British Journal of Sociology*, 49(3), 375-398. <http://dx.doi.org/10.2307/591389>

- Eccles, J. S. (1987). Gender Roles and Women's Achievement-Related Decisions. *Psychology of Women Quarterly*, 11(2), 135–172. <https://doi.org/10.1111/j.1471-6402.1987.tb00781.x>
- Ellison G., & Swanson A. (2010), The Gender Gap in Secondary School Mathematics at High Achievement Levels: Evidence from the American Mathematics Competitions, *Journal of Economic Perspectives*, 24 (2), 109–128.
- European Commission. (2014). A new method to understand occupational gender segregation in European labour markets. Luxembourg: Publications Office of the European Union. Retrieved from http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/150119_segregation_report_web_en.pdf.
- Eurostat. (2018). Statistics Explained, Gender Pay Gap Statistics. Retrieved from http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Gender_pay_gap_statistics
- Evans, M. A., Whigham, M., & Wang, M. C. (1995). The effect of a role model project upon the attitudes of ninth-grade science students. *Journal of Research in Science Teaching*, 32(2), 195–204. <http://dx.doi.org/10.1002/tea.3660320208>.
- Furnham, A., Reeves R., & Budhani S. (2002). Parents Think Their Sons Are Brighter Than Their Daughters: Sex Differences in Parental Self-Estimations and Estimations of Their Children's Multiple Intelligences, *The Journal of Genetic Psychology*, 163 (1), 24–39, DOI: 10.1080/00221320209597966
- Kaçaniku, F., (2015), Gender and Selection of Undergraduate Programs: Factors Affecting Career Aspirations of Females in Prishtina District, RIT Scholar Works, Thesis/Dissertation Collections. <http://scholarworks.rit.edu/theses>
- Lindberg, S. M., Hyde, J. S., Petersen, J. L., & Linn, M. C. (2010). New trends in gender and mathematics performance: a meta-analysis. *Psychological bulletin*, 136(6), 1123–1135. doi:10.1037/a0021276
- Maloku, E., Derks, B., van Laar, C., & Ellemers, N. (2018). Stimulating interethnic contact in Kosovo: The role of social identity complexity and distinctiveness threat. *Group Processes & Intergroup Relations*. <https://doi.org/10.1177/1368430218808884>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë MASHT (2015). Statistikat e Arsimit në Kosovë. Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim. Retrieved from: https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/07/statistikat2014-15compressed_1.pdf
- OECD. (2013). Mathematics Self-Beliefs and Participation in Mathematics-Related Activities, In PISA 2012 Results: Ready to Learn – Students' Engagement, Drive and Self-Beliefs (Volume III), OECD Publishing. Retrieved from http://www.oecd-ilibrary.org/education/pisa-2012-results-ready-to-learn-volume-iii_9789264201170-en
- OECD. (2018). PISA 2015 Results in Focus, retrieved from: <https://www.oecd.org/pisa/pisa-2015-results-in-focus.pdf>.
- Qing L. (1999). Teachers' beliefs and gender differences in mathematics: a review, *Educational Research*, 41(1), 63–76, DOI: 10.1080/0013188990410106.
- Rozek, C. S., Svoboda, R. C., Harackiewicz, J. M., Hulleman, C. S., & Hyde, J. S. (2017). Utility-value intervention with parents increases students' STEM preparation and career pursuit. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America*, 114(5), 909–914. doi:10.1073/pnas.1607386114.

- Steele, C. M., & Aronson, J. (1995). Stereotype threat and the intellectual test performance of African Americans. *Journal of Personality and Social Psychology*, 69(5), 797-811.
- Steele, J. R. (2003). Children's gender stereotypes about math: The role of stereotype stratification. *Journal of Applied Social Psychology*, 33(12), 2587-2606. doi:10.1111/j.1559-1816.2003.tb02782.x
- Stout, J. G., Dasgupta, N., Hunsinger, M., & McManus, M. A. (2011). STEMing the tide: Using ingroup experts to inoculate women's self-concept in science, technology, engineering, and mathematics (STEM). *Journal of Personality and Social Psychology*, 100(2), 255-270
- Su, R., Rounds, J., & Armstrong, P. I. (2009). "Men and things, women and people: A meta-analysis of sex differences in interests". *Psychological Bulletin*, 135(6), 859-884. doi:10.1037/a0017364.
- The World Bank. (2012). Kosovo: Gender Gaps in Education, Health and Economic Opportunities. Report 75930 - KV. Retrieved from: <http://documents.worldbank.org/curated/en/371251468030245833/Kosovo-Gender-gaps-in-education-health-and-economic-opportunities>
- Todaro, M., and S. Smith (2012). *Economic Development*, 11th edition. Addison Wesley: United States.
- Turner, S. E., & Bowen, W. G. (1999). Choice of major: The changing (unchanging) gender gap. *Industrial & Labor Relations Review*, 52(2), 289-313
- Weinhardt, Von F. (2017). Ursache für Frauenmangel in MINT Berufen? Mädchen unterschätzen schon in der fünften Klasse ihre Fähigkeiten in Mathematik. Retrieved from: http://www.diw.de/en/diw_01.c.568725.en/topics_news/why_are_fewer_women_working_in_stem_fields_girls_underestimate_their_math_abilities_in_school.html
- Wiest, L. R. (2014). Strategies for parents to support daughters in STEM. Reno, NV: University of Nevada, Reno. Retrieved from <http://www.unr.edu/girls-mathcamp/resources/parents/tips>.
- Wilder, G.Z., & Powell K. (1989). Sex differences in test performance: a survey of literature. ETS Research Report. Report number: CBR-89-03, RR-89-04. <http://dx.doi.org/10.1002/j.2330-8516.1989.tb00330.x>

SHTOJCA 1. PYETËSORI

Përshëndetje,

Të ftojme që të marrësh pjesë në një studim mbi vendim-marrjen e nxënësve të Kosovës për zgjedhjen e profesioneve të tyre në të ardhmen. Ne duam të kuptojmë se si nxënësit kosovarë i marrin këto vendime dhe çfarë roli luajnë familja, shkolla, mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi në vendimin-marrje. Nuk ka përgjigje të saktë apo të gabuar. Ne thjesht jemi të interesuar për mendimin tënd të sinqertë. Plotësimi i anketës zgjatë më së shumti 15 minuta.

Të sigurojmë se kjo anketë është anonime dhe emri yt nuk do të vendoset në pyetësor. Të dhënat nga ky studim do të përdoren vetëm për qëllime shkencore.

Nëse ke ndonjë pyetje rreth studimit apo dëshiron më shumë informacione rreth tij, mund të kontaktosh autorët e studimit në **center.leap@gmail.com**.

Nëse pajtohesh me pjesëmarrjen, të lutem thuaj

1. PO - dua të marrë pjesë në këtë studim (Aprovim)

Nëse NUK pajtohesh me pjesëmarrjen, atëherë thuaj

2. JO - nuk dua të marrë pjesë në këtë studim (Mosaprovim)

(Vërejtje: Aprovimi apo Mosaprovimi për pjesëmarrje shënohet në tablet nga intervistuesi/sja)

PJESA 1(A): TË PLOTËSOHET NGA INTERVISTUESI/SJA

Nr. i anketës:

Emri i intervistuesit/ses:

Data e anketimit:

Vendi dhe Komuna:

A. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	
A1. Gjinia	1. M 2. F
A2. Moshë	Shëno me numër: _____
A3. Vendlindja (vendi ku ke kaluar fëmijërinë)	Komuna: _____ Të lutem specifikoj nëse 1. Rural 2. Urban
A4. Etnia	
A5. Cili është drejtimi që vijon në shkollë të mesme? (Vërejtje: Të zgjidhet vetëm një opcion)	1. Gjinnaz: <ul style="list-style-type: none"> 1.1 përgjithshëm 1.2 Shkenca natyrore 1.3 Shkenca shoqërore 1.4 Matematikë-informatikë 1.5 Gjuhësor 1.6 Tjetër (specifiko) _____ 2. Shkolla profesionale <ul style="list-style-type: none"> 2.1 Teknik 2.2 Ekonomik 2.3 Bujqësor 2.4 Mjekësi 2.5 Muzikë 2.6 Tregti 2.7 Teologji 2.8 Art 2.9 Qendër e kompetencës 2.10 Tjetër (specifiko) _____
A6. Klasa	1. 11-të 2. 12-të
A7. Suksesi i përgjithshëm në <u>klasën e 5-të</u>	1. I dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë i mirë 5. Shkëlqyeshëm 6. Nuk e di/Nuk më kujtohet
A8. Suksesi i përgjithshëm në <u>klasën e 9-të</u>	1. I dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë i mirë 5. Shkëlqyeshëm 6. Nuk e di/Nuk më kujtohet
A9. Suksesi i përgjithshëm në <u>klasën e 10-të</u>	1. I dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë i mirë 5. Shkëlqyeshëm 6. Nuk e di/Nuk më kujtohet
A10. Nota përfundimtare në lëndën e matematikës në shkollën e mesme të lartë deri tani (Shëno mesataren me numër)	1. Klasa 10: _____ 2. Klasa 11: _____ 3. Klasa 12: _____ 3.1 E paaplikueshme (Vërejtje: nëse nxënësi është ende në klasën 11, atëherë klasa 12 të shënohet e paaplikueshme)
A11. Nota përfundimtare në lëndën e gjuhës amtare në shkollën e mesme të lartë deri tani (Shëno mesataren me numër)	1. Klasa 10: _____ 2. Klasa 11: _____ 3. Klasa 12: _____

A12. INFORMACIONI PËR FAMILJEN

Në vijim do të t'pyesim për anëtarët e familjes tënde të ngushtë: pra nënën, babanë dhe vëllezërit /motrat që janë 18 vjeç ose më shumë (Vërej: mos përfshi anëtarë të familjes që janë më pak se 18 vjeç).

(Vërej: Në kolonën 1 të tabelës shënohen pjesëtarët e familjes së ngushtë për të cilët jipet përgjigja, dmth: nëna, babai, vëllai 1, vëllai 2, motra 1, motra 2, etj, varësisht sa anëtarë të familjes janë. Më pas, në kolonën 2 plotëso nivelin e shkollimit të gjithsecilit, në kolonën 3 statusin e punësimit të gjithsecilit, dhe në kolonën 4 profesionin e tyre, të cilin duhet ta shkruani me fjalë. Për ata që kanë profesion të papërcaktuar, mund të shkruani PA = E paaplikueshme).

Kolona 1	Kolona 2	Kolona 3	Kolona 4
	Niveli më i lartë i shkollimit: 1. Nuk ka përfunduar shkollën fillore 2. Ka përfunduar shkollën fillore 3. Ka përfunduar shkollën e mesme 4. Vijon shkollën e lartë/universitetin 5. Ka përfunduar shkollën e lartë/ universitetin 6. Vijon masterin 7. Ka përfunduar masterin 8. Vijon doktoraturën	Statusi i tanishëm i punësimit: 1. Punësuar në sektorin privat 2. Punësuar në sektorin publik/shtetëror 3. Vetëpunësuar (ka biznesin e vet) 4. Punësuar jashtë vendit 5. Në pension 6. Student/e 7. Nuk Punon	Profesioni (si shembull: Mësues/e, Mjek/e, Profesor/esh, Arkitekt/e, Polic/e, Bujkë, Amvis/e, Kontabilist/e, Infermier/e, Avokat/e, Ekonomist/e, etj).
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			
...			

PJESA 2 (B): PËRVOJA NË SHKOLLË DHE VETËPERCEPTIMI AKADEMIK

B1. Cilat janë 3 lëndët tua më të preferuara në shkollë? (Vërej: rrumbullakëso lëndën që thotë respondentin; mund të zgjedhë deri në 3 lëndë):

1. Gjuhë amtare
2. Gjuhë të huaja
3. Matematikë
4. Fizikë
5. Kimi
6. Bologji
7. Informatikë
8. Art muzikor
9. Art figurativ
10. Kulturë fizike
11. Histori
12. Gjeografi
13. Filozofi,
14. Psikologji
15. Sociologji
16. Ekonomi
17. Edukatë qytetare
18. Tjetër (specifiko) _____

B2. B2. Lëndët e cekura janë të preferuara për ty sepse: (Vërej: Lexo opcionet dhe lejo respondentin të zgjedhë disa opzione):

1. Përmbajtja e lëndës është interesante
2. Më pëlqen mënyra se si e shpjegon profesori/esha
3. Se është lëndë e lehtë për t'u mësuar dhe kuptuar
4. Se kam dëshirë t'a sfidoj veten
5. Se gjithmonë kam patur aftësi për lëndë të tilla
6. Se nuk kam aftësi për lëndët tjera
7. Tjetër (specifiko) _____

B3. Në cilat prej këtyre lëndëve i ke notat më të mirat? (Vërej: rrumbullakëso lëndën që thotë respondenti; mund të zgjedhë më shumë se 1 lëndë. Përrjashtim në këtë rregull bëjnë vetëm rastet kur respondenti zgjedhë opcionet 16 = Në të gjitha, apo 17 = Në asnjërën)

11. Gjuhë amtare
2. Gjuhë të huaja
3. Matematikë
4. Fizikë
5. Kimi
6. Biologji
7. Informatikë
8. Art muzikor
9. Art figurativ
10. Kulturë fizike
11. Histori
12. Gjeografi
13. Filozofi,
14. Psikologji
15. Sociologji
16. Ekonomi
17. Edukatë qytetare
18. Në të gjitha
19. Në asnjërën
20. Tjetër (specifiko) _____

B4. B4. Sa mendon se je i/e aftë në lëndën e matematikës? (1=aspak; 5=shumë)
1.....2.....3.....4.....5

B5. Sa mendon se je i/e aftë në lëndët e gjuhëve? (1=aspak; 5=shumë)
1.....2.....3.....4.....5

B6. Sa pajtohesh me deklaratat e mëposhtme? (1=nuk pajtohem aspak; 5=pajtohem plotësisht)

Deklarata:	1	2	3	4	5
1. Unë e mësoj matematikën shumë shpejt					
2. Matematika është shumë lëndë e vështirë					
3. Stresohem shumë kur jam në orë të matematikës					
4. Brengosem se çfarë notë përfundimtare do të marr në matematikë					
5. Matematika më duket lëndë shumë interesante					
6. Stresohem shumë gjatë provimeve të matematikës					
7. Kam vetëbesim që të dalë të zgjedhë detyra në tabelë në orën e matematikës					
8. Profesori/esha më nxitë që të flasë në orën e matematikës					

Përshtatur nga OECD (2013).

B7. Sa pajtohesh me deklaratat e mëposhtme? (1=nuk pajtohem aspak; 5=pajtohem plotësisht)

Deklarata:	1	2	3	4	5
1. Vajzat janë zakonisht të zonjat në matematikë					
2. Vajzat janë zakonisht të zonjat në gjuhë					
3. Vajzat janë zakonisht të zonjat në sport					
4. Vajzat janë zakonisht të urta në klasë					
5. Vajzat janë zakonisht të zhurmshëme në klasë					
6. Djemtë janë zakonisht të zotë në matematikë					
7. Djemtë janë zakonisht të zotë në gjuhë					
8. Djemtë janë zakonisht të zotë në sport					
9. Djemtë janë zakonisht të urtë në klasë					
10. Djemtë janë zakonisht të zhurmshëme në klasë					
11. Nuk besoj se ka ndonjë dallim se a je vajzë apo djalë për të qenë i zoti/e zonja në një lëndë të caktuar					

PJESA 3 (C): ZGJEDHJA E FUSHËS SË STUDIMIT (ROLI I FAMILJES, SHOQËRISË DHE QENDRAVE PËR KËSHILLIM NË KARRIERË)

C1. A je përcaktuar ende se çka dëshiron të studiosh në Universitet?

1. Po
2. Jam duke menduar por ende nuk kam vendosur
3. Jo
4. Nuk kam fare ide se çka do të studioj
5. Nuk dua të vazhdoj studimet universitare fare

PYETJE FILTER: Nëse zgjedhet opcioni 1) Po; apo opcioni 2) Jam duke menduar por ende nuk kam vendosur; të figurojë në tablet pyetja në vijim:

FC1-A: Cilën fushë don ta studiosh? (Vërej: të zgjedhet vetëm 1 opcion)

1. Gjuhët
2. Matematikë
3. Ekonomi
4. Juridik
5. Kulturë fizike
6. Biologji
7. Kimi
8. Fizikë
9. Shkenca kompjuterike
10. Arkitekturë
11. Ndërtimtari
12. Edukim (mësuesi)
13. Psikologji
14. Bujqësi
15. Shkenca Politike
16. Farmaci
17. Mjekësi
18. Studime për zanat (specifiko) _____
19. Tjetër (specifiko) _____

PYETJE FILTER: Nëse zgjedhet opcioni 3 dhe 4) Nuk di se çka do të studioj; të figurojë në tablet pyetja në vijim:

FC1-B: Pse nuk je përcaktuar ende?

1. Sepse nuk kam informata mbi fushat e studimeve
2. Sepse familja më thotë të studioj diçka e unë dua të studioj diçka tjetër
3. Sepse ajo çka dua të studioj unë (fusha/drejtimi) kushton shumë
4. Sepse aktualisht nuk më pëlqen asnjë drejtim
5. Sepse edhe shokët/shoqen nuk kanë vendosur ende
6. Sepse ajo që më pëlqen nuk paguhet mirë (sqarim eventual: rroga nuk është e mirë)
7. Tjetër (specifiko) _____

C4. Pse e preferon këtë fushë studimi? (Vërej: Respondenti mund të zgjedhë më shumë se 1 përgjigje)

1. Se më ka pëlqyer gjithmonë kjo fushë/ky profesion
2. Se është lehtë të gjej punë në të ardhmen
3. Sepse paguhet mirë
4. Se i kam notat e mira në këtë fushë
5. Se ky profesion më shkon me natyrën time si person/personalitetin tim
6. Se prindërit më kanë sugjeruar se ky është profesioni i duhur për mua
7. Se profesorët më kanë sugjeruar se kam aftësi në këtë fushë/profesion
8. Se shokët dhe shoqet më kanë thënë se jam /ie aftë në këtë fushë/profesion
9. Konsideroj që ky është profesioni që do të kërkohet më së shumti në të ardhmen
10. Shoket/shoqet më të ngushta shkojnë në të njëjtin drejtim
11. Tjetër (specifiko) _____

C5. Nëse nuk mund të pranohesh në këtë fakultet/fushë studimi, cila do të ishte zgjedhja jote e dytë? (Vërej: të zgjedhet vetëm 1 opcion)

1. Gjuhët
2. Matematikë
3. Ekonomi
4. Juridik
5. Kulturë fizike
6. Biologji
7. Kimi
8. Fizikë
9. Shkenca kompjuterike
10. Arkitekturë
11. Ndërtimtari
12. Edukim (mësuesi)
13. Psikologji
14. Bujqësi
15. Shkenca Politike
16. Farmaci
17. Mjekësi
18. Studime për zanat (specifiko) _____
19. Nuk e di/Nuk kam ide
20. Tjetër (specifiko) _____

C6. Sa shpesh të ka ndodhë deri tash që të bisedosh me prindërit rreth fushës së studimeve të ardhshme? (1=asnjëherë; 5 = shumë shpesh; 6=nuk di/nuk kam përgjigje)

1.....2.....3.....4.....5; 6

C7. A përputhen sugjerimet e prindërve të tu me planet dhe ëndërrat tua për të ardhmen?

1. Po
2. Jo
3. Deri diku
4. Nuk di/Nuk kam përgjigje

PYETJE FILTER: Nëse zgjedhet opcioni 2) Jo, apo opcioni 3) Deri diku; të figurojë në tablet pyetja në vijim:

FC7. Çka i bënë planet tua rreth zgjedhjes së profesionit të ndryshojnë nga sugjerimet e prindërve tu? (Vërej: Respodenti mund të zgjedhë më shumë se 1 opcion):

1. Ata më sugjerojnë të studioj një fushë që mua nuk më pëlqen
2. Ata më sugjerojnë se duhet të studioj një fushë (në një shkollë të lartë/Fakultet) që nuk është e shtrenjtë (nuk kushton)
3. Ata më sugjerojnë se është më mirë të studioj për një profesion të ngjashëm me një nga anëtarët e familjes (nana/baba, motra/vëllau)
4. Ata më sugjerojnë se është më mirë të studioj për një profesion që konsiderohet si më i lehtë për t'u kryer
5. Ata më sugjerojnë se është më mirë të studioj për një profesion që konsiderohet se është më i vështirë për t'u kryer
6. Ata më sugjerojnë që të gjej një drejtim me të cilin mund të gjej punë më lehtë
7. Ata më sugjerojnë që të gjej një drejtim/profesion që më përshtatet mua, pasi që jam natyrë e butë dhe e kujdesshme
8. Ata më sugjerojnë që të gjej një drejtim/profesion që më përshtatet mua, pasi që jam natyrë më ambicioz/e
9. Ata më sugjerojnë që të gjej një drejtim/profesion që është elitare (të bën dikushi në shoqëri)
10. Tjetër (specifiko): _____

C8. A ke pasë mundësi të këshillohesh me ndonjë qendër për orientim në karrierë për të vendosur për profesionin tënd të ardhshëm?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk kam dëgjuar fare për qendra të orientimit në karrierë

PYETJE FILTER: Nëse zgjedhet opcioni nën 1) Po; të figurojë në tablet pyetja në vijim:

FC8. Sa kanë ndikuar këshillimet e tilla në vendimin tënd për karrierën e ardhshme? (1=aspak; 5=shumë)

1.....2.....3.....4.....5

PJESA 4 (D): STEREOTIPET GJINORE - PERCEPTIMET RRETH VETES DHE PROFESIONEVE SPECIFIKE GJINORE

Për fund, kemi edhe disa pyetje rreth asaj se si ti e sheh veten dhe të tjerët në disa aspekte.

D1. Sa pajtohesh me deklaratat e mëposhtme? (1=nuk pajtohem aspak; 5=pajtohem plotësisht)

(Vërejtje për autorët e studimit: Besimet personale: besimet komunale [communal], për pushtetin dhe të arritjes; HEED vs. STEM adaptuar nga studimi multi-kulturor UCOM, 2018)

Deklarata:	1	2	3	4	5
1. Është me rëndësi që t'ju ndihmojë të tjerëve					
2. Është me rëndësi që të kujdesem për të tjerët					
3. Është më rëndësi që të përmbushë nevojat e të tjerëve					
4. Është me rëndësi që të kem pushtet (fuqi)					
5. Është me rëndësi që të kem një pozitë në shoqëri					
6. Është me rëndësi që të jem mbi të tjerët (superior)					
7. Është me rëndësi që të arrijë në jetë					
8. Është me rëndësi që të jem i/e aftë në jetë					
9. Është me rëndësi që të jem i/e sukseshëm/me në jetë					

D2. Nëse i paramendon njerëzit që zakonisht punojnë në profesionet që do t'i themi në vijim, a mendon se ka më shumë burra në këto profesione, më shumë gra apo që të dyja gjinitë punojnë njëjtë në këto profesione? (Vërej: lexoja respondentit kategoritë e shkallës një nga një) (Vërejtje për autorët e studimit: Perceptimet për fushat/profesionet specifike gjinore; HEED vs. STEM adaptuar nga studimi multi-kulturor UCOM, 2018)

Deklarata:	1	2	3	4	5
	Vetëm Burrat	Burrat pak më shumë	Burrat dhe gratë njëjtë	Gratë pak më shumë	Vetëm gratë
1. Në Kosovë, kush punon si infermier/e?					
2. Në Kosovë, kush punon si mësuese/e në shkolla fillore?					
3. Në Kosovë, kush punon si arkatar/e?					
4. Në Kosovë, kush punon si specialiste në ICT?					
5. Në Kosovë, kush punon si inxhinier/e elektrik/e?					
6. Në Kosovë, kush punon si arkitekt/e?					

D3. Kush mendon se duhet të punojë në profesionet në vijim?

(Vërejtje për autorët e studimit: Normat urdhëruese {injunctive norms; what ought to be} për fushat/profesionet specifike gjinore –HEED vs STEM; adaptuar nga studimi multi-kulturor UCOM, 2018)

Deklarata:	1	2	3	4	5
	Vetëm Burrat	Burrat pak më shumë	Burrat dhe gratë njëjtë	Gratë pak më shumë	Vetëm gratë
1. Kush mendon se duhet të punojë si infermier/e?					
2. Kush mendon se duhet të punojë si mësuese/e në shkollë fillore?					
3. Kush mendon se duhet të punojë si arkatar/e?					
4. Kush mendon se duhet të punojë si specialist/e në ICT?					
5. Kush mendon se duhet të punojë si inxhinier/e elektrik/e?					
6. Kush mendon se duhet të punojë si arkitekt/e?					

D4. Sa pajtohesh me deklaratat e mëposhtme? (1=nuk pajtohem aspak; 5=pajtohem plotësisht)

(Vërejtje për autorët e studimit: Vlerësimet personale –vetë-efikasiteti dhe përputhja e vlerave; 3 pyetje nga secila HEED vs. STEM; adaptuar nga studimi multi-kulturor UCOM, 2018)

Deklarata:	1	2	3	4	5
1. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si infermier/e					
2. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si mësues/e në shkollë fillore					
3. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si arkatar/e					
4. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si specialist/e i/e teknologjisë informative (sektori i ICT)					
5. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si inxhinier/e elektrik/e					
6. Do të isha i/e aftë që të kem një karrierë të suksesshme si arkitekt/e					
7. Profesioni i infermierit/es përputhet me vlerat e mia (sqarim eventual: vlerat = besimet, parimet e mia)					
8. Profesioni i mësuesit/es në shkollë fillore përputhet me vlerat e mia					
9. Profesioni i arkatarit/es përputhet me vlerat e mia					
10. Profesioni i specialistit/es në sektorin e ICT përputhet me vlerat e mia					
11. Profesioni i inxhinierit/es elektrik/e përputhet me vlerat e mia					
12. Profesioni i arkitektit/es përputhet me vlerat e mia					

D5. Sa pajtohesh me deklaratat e mëposhtme? (1=nuk pajtohem aspak; 5=pajtohem plotësisht)

(Vërejtje për autorët e studimit: Rolet tradicionale gjinore: adaptuar nga studimi multi-kulturor,UCOM, 2018)

Deklarata:	1	2	3	4	5
1. Në vendet e punës ku ka edhe burra edhe gra, është më mirë që burrat të jenë në pozita udhëheqëse					
2. Burrat janë liderë/udhëheqës më të mire					
3. Vendi i gruas është në shtëpi					

PËRFUNDIM:

Kjo ishte e tëra! Faleminderit shumë për pjesëmarrjen dhe përgjigjet e dhëna. Të rikujtoj se nëse ke ndonjë pyetje rreth studimit apo dëshiron më shumë informacione rreth tij, mund të kontaktosh autorët e studimit në **center.leap@gmail.com**

SHTOJCA 2. UDHËZUESI PËR FOKUS GRUPET

1. Hyrja

Mirë se keni ardhur. Fillimisht, do të donim t'iu falënderonim për gatishmërinë tuaj për të marrë pjesë në këtë diskutim. Sot do të diskutojmë rreth procesit të vendim-marrjes suaj për zgjedhjen e profesioneve tuaja në të ardhmen. Është shumë e rëndësishme për ne t'iu kemi juve sot këtu dhe t'i dëgjojmë mendimet tuaja rreth kësaj teme. Ne duam të kuptojmë se si ju i merrni këto vendime dhe çfarë roli luajnë familja, shkolla, mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi në këtë proces. Në pjesën e parë të diskutimit do të flasim më shumë rreth lëndëve tuaja të preferuara në shkollë dhe arsytet e preferencës tuaj për lëndët e caktuara. Gjatë pjesës së dytë do të diskutojmë për faktorët që ndikojnë përzgjedhjen së drejtimit tuaj të tanishëm, si dhe atij të ardhshëm (për ju që jeni ende në shkollë të mesme). Fare në fund do të fokusohemi më shumë në llojet e profesioneve dhe si i shihni ju bazuar në aspektin gjinor.. Së bashku, do të diskutojmë rreth 1 orë e gjysmë. Para se të fillojmë, ne do t'ua prezantojmë Rregullat Themelore të Fokus Grupit, të cilat nuk duhet domosdoshmërisht të respektohen me përpikëri, pasi që për ne është më e rëndësishme që ju të mbani mend që ne duam që ju të jeni ata që do ta zhvillonin diskutimin.

Rregullat Themelore të Fokus Grupit:

Ne duam të dëgjojmë secilin nga ju. Mos prisni që ne t'iu thërrasim.

Nuk ka nevojë ta ngrisni dorën. Ju lutem, ndjehuni të lirshëm ta shprehni mendimin tuaj në çdo pyetje. Nuk ka përgjigje të drejtë ose të gabuar.

Respektoni mendimin e çdonjërit, dhe mos e ndërprisni njëri-tjetrin gjatë bisedës.

Ju lutem flisni një nga një dhe ngrisni zërin kur flisni kështu që secili nga ne të mund t'iu dëgjoj.

Nëse e vërejmë që dikush nuk ka folur akoma, mund të ndodh që mund ta thërrasim atë ose ta pyesim për mendimin e tij/saj.

Në mënyrë që t'i kuptojmë qartë mendimet tuaja dhe të mund ta shkruajmë raportin pas takimit, neve na duhet ta incizojmë bisedën. Megjithatë, ne ju sigurojmë që mendimet e juaja do të mbesin plotësisht anonime dhe do të përdoren VETËM për qëllime studimi. Në mënyrë që t'i kuptojmë qartë mendimet tuaja dhe të mund ta shkruajmë raportin pas takimit, neve na duhet ta incizojmë bisedën. Megjithatë, ne ju sigurojmë që mendimet e juaja do të mbesin plotësisht anonime dhe do të përdoren VETËM për qëllime studimi.

Ju lutem, fikni telefonat celular dhe mos u largoni deri në fund të takimit.

Nëse të gjithë jemi gati, atëherë do të doja të filloja me prezantimin e shkurt të secilit nga ju, duke treguar emrin/vitin e shkollimit/drejtimit e shkollimit dhe vazhdojmë me pyetjet tjera.

2. Diskutimi

Pyetje Hyrëse:

1. A mund të na tregoni se cilat janë/ose kane qenë dy lëndët tuaja më të preferuarat në shkollë?

Pyetje hetuese:

-Çfarë i bënë/i ka bërë ato të preferuara për ju? (p.sh. përmbajtja e lëndës, sa janë të lehta apo vështira, është e dobishme për studime apo profesion më vonë, etj?)

Pyetje për Diskutim

2. Nëse flasim specifikisht për lëndën e Matematikës, sa vlerësoni se jeni të aftë/të zotë në këtë lëndë?

Pyetje hetuese:

- Në çka e bazoni këtë vlerësim?
- A mund të na tregoni se si ndiheni/jeni ndjerë gjatë zhvillimit të orës së matematikës?
- Po gjatë testeve në këtë lëndë?
- Sa është/ka qenë me rëndësi për ju nota përfundimtare në këtë lëndë?

3. Po kur flasim për lëndët e Gjuhëve, sa vlerësoni se jeni të aftë/të zotë në këtë lëndë?

Pyetje hetuese:

- Në çka e bazoni këtë vlerësim?
- A mund të na tregoni se si ndiheni/jeni ndjerë gjatë zhvillimit të orës së gjuhëve?
- Po gjatë testeve në këtë lëndë?
- Sa është/ka qenë me rëndësi për ju nota përfundimtare në këtë lëndë?

4. Nëse dikush thotë se vajzat janë më të mira në shkenca shoqërore (psh ...) ndërsa djemtë në ato natyrore (psh...), çfarë do t'i thoni ju? Ju lutem arsyetoni mendimin tuaj.

- Po ju si mendoni se qëndrojnë vajzat e djemtë me performancë në shkenca shoqërore dhe ato natyrore?

5. Cili është drejtimi i studimeve tuaja aktuale (për studentët që vijnë fakultetin) /drejtimi i studimeve në të ardhmen (për nxënësit që vijnë shkollën e mesme)?
(Shënim: Nëse nxënësit e shkollave të mesme deklarojnë se nuk janë përcaktuar ende për drejtimin e studimeve, u kërkohet të hamendësojnë profesionin/apo fushën e studimeve të cilën ata mendojnë që kanë mundësi ta përzgjedhin në të ardhmen)

6. Ju lutem, a mund të na tregoni cilët janë faktorët që kane ndikuar vendimin për fushën e studimit?

Pyetje hetuese:

- Gjatë këtij procesi, a jeni konsultuar me dikë ose a keni marrë këshillë nga dikush?

Moderator: përmendi grupet e mëposhtme për të marrë mendime

- a) Familjen/Rrethin familjar
- b) Shoqërinë
- c) Shkollën/ Stafin akademik
- d) Qendrat për këshillim në karrierë (sa janë te informuar dhe sa i përdorin?)

7. Sa mendoni që vendimi juaj për studimet në fushën e caktuar është në pajtueshmëri/kundërshtim me pritjet nga familjarët, shoqëria ose persona të tjerë?

Pyetje hetuese:

- e) Sa shpesh ju ka ndodhë deri tani që të bisedoni me prindërit rreth fushës së studimeve /profesionit tuaj të ardhshëm?
- f) Sa ndihmuese kanë qenë këto biseda me ta?
- g) Sa përputhen sugjerimet e prindërve tuaj me planet dhe ëndrrat tuaja për të ardhmen?
- h) Cilat kanë qenë këshillat më të zakonshme të cilat i keni marrë nga ata?
- i) Sa kanë anuar prindërit për studime/profesionet të caktuara?
- j) Çfarë arsyesh ju kanë dhënë ata për atë lloj studimi/profesionit?

8. Sa konsideroni që lëndët e caktuara në shkollë/profesionet e caktuara përkojnë me natyrën dhe ambiciet tuaja për të ardhmen? Arsyetoni mendimin tuaj.

Pyetje hetuese:

- Cilat do të ishin arsyet kryesore mbi përzgjedhjen tuaj në këtë rast?

9. Tani, në letrat e shënimit të cilat do t'u ofrohen, ju lutem shënoni arritjen akademike dhe profesionin e prindërve tuaj (Babës dhe Nënës) si dhe fushën tuaj të studimit (për nxënësit e shkollës së mesme, të shënohet fusha të cilën mendojnë ta studiojnë)?

Pyetje hetuese:

- k) A mendoni që profesionet e prindërve tuaj kanë ndikim në zgjidhjen e studimeve/profesionit tuaj në të ardhmen? Nëse po, si mendoni që ndodhë kjo?
- 10. Cili është profesioni në të cilin do të kishit dëshirë të punonit në të ardhmen?

11. Cilat profesione mendoni se janë më të përshtatshme për një vajzë dhe cilat profesione i konsideroni si më të përshtatshme për një djalë në shoqërinë kosovare? Ju lutem arsyetoni mendimin tuaj.

(Moderatori duhet të ketë parasysh mendimin e pjesëtareve të fokus grupit në profesionet e mëposhtme)

Infermier/e

Mësues/e i/e shkollave fillore

Sekretar/eshë

Arkëtar/e

Specialist/e i/e Teknologjisë Informativë

Inxhinier/e i/e Elektricitetit

Arkitekt/e

Mjek/e

Dentist/e

Edukator/e

12. Pavarësisht mendimit tuaj rreth asaj se cilat profesione janë më të përshtatshme për gjini të caktuar, aktualisht, cilat profesione mendoni që ushtrohen më shumë nga djemtë e cilat nga vajzat? (rikujtojeni listën e profesioneve këtu)

Pyetje hetuese:

- Përse mendoni se ndodhë kjo?

13. Kur mendoni për profesionin tuaj në të ardhmen, a do të ishte më e rëndësishme për ju të zgjidhni një profesion përmes të cilit do të mund t'i ndihmoni të tjerëve, apo që ai profesion të ju sigurojë status/ fuqi në shoqëri?

14. Sa e përcaktojnë të ardhurat e mundshme financiare përzgjedhjen tuaj për profesionin e caktuar? Ju lutem arsyetoni mendimin tuaj.

Pyetje hetuese:

- Çfarë ndikimi mendoni se do të arrini në shoqëri duke ushtruar profesionin tuaj?

15. Në përgjithësi, pjesëtarët e cilës gjini janë më të përshtatshëm për pozita udhëheqëse dhe leadership (burrat apo gratë)? Arsyetoni mendimin tuaj.

Pyetje hetuese:

- Sipas jush, a duhet të ketë më shumë burra apo gra në pozita udhëheqëse?

Arsyetoni mendimin tuaj.

- Çka mund të bëjmë që ta arrijmë këtë gjë?

16. Sektori i Teknologjisë dhe Informacioni është njëri ndër sektorët ku ka më së shumti kërkesë për punëtorë si dhe është një profesion fitimprurës. Megjithatë, nëse bazohemi në të dhënat statistikore mbi këtë sektor, dominon dukshëm numri i meshkujve që studiojnë dhe punojnë në këtë fushë, krahasuar me femrat.

Pyetje hetuese:

- Sipas jush, pse ekziston ky dallim?

- Çka mund t'i shtyjë femrat që të preferojnë shumë pak Studimin e kësaj fushe dhe më pas ushtrimin e profesionit në sektorin e Teknologjisë?

- Si mund të ndryshohet kjo gjë?

